NË KËTË NUMËR LEXONI


6 Intervistë me dr. Hysen Matoshin


9 Kush do t'i fitojë zgjedhjet...


11 Po bëhen gati pasaportat...


15 Rast i mirë për shtetin e ri


38 Futbolli duhet te presë politikën

Lajme 2

Milazim Krasniqi: Konfuzion i ri, iluzione të vjetra . 3

Florije Ademi: "Kodra e minatorëve" rrezikon të mbetet pa asnjë banor shqiptar 4-5

Intervistë me dr. Hysen Matoshin 6-8

Avni Avdiu: Kush do t'i fitojë zgjedhjet në Maqedoni? 9-10

Bujar Sejdiu: Po bëhen gati pasaportat e Republikës së Kosovës 11-12

Gëzim Qerimi: Domosdoshmëria e ndërkombëtarizimit të UP-së 12-13

Fitim Veliu: Fenomeni i braktisjes së shkollës dhe delikuenca 14

Sead Ujkani: Rast i mirë për shtetin e ri 15

Emine A. Vezaj: "Big Brother" dhe shqiptarët 16-17

Demir Reshiti: Bie interesimi për Kosovën 18-19

Osman D. Gashi: Fotoreportazhi 20-21

Batjar Halili: Çrregullimi autik 22-23

Muhamed Jusufi – Kajolli: Ekspedita e fundit e Muhammedit s.a.v.s. 24-25

Ali Iljazi: Begatia e shëndetit nga këndvështrimi i Muhammedit a.s. 26-27

Mimoza Sinani: Shtegtim deri në agim 28-29

Flamur Maloku: Shkrimi kah metapërjetimi personal 30-31

Muhamed Çitaku: Diskursi kur'anor në letërsinë shqipe(1) 31

Poezi 32

Berat Dakaj: Letërsi e çmendur 33-34

Mirsad Kuteli: Struktura e skemës piramidale për arritjen e suksesit 35

Artan Bejta: Aknet – "Puçrrat e rinisë" 36-37

Liridon Iberdemaj: Futbolli duhet të presë politikën 38-39

Fjalëkryqi 40



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË

Viti III / Nr. 18

19 maj - 19 qershor 2008

Botues

Zëri Ynë

O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor

Muhamed Jusufi - KAJOLLI

kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës

Demir RESHITI

demireshiti@hotmail.com

Redaktor i kulturës

Flamur MALOKU

flamurmaloku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika

Osman D. GASHI

osmangashi@msn.com

Anëtarët e redaksisë:

Arber ZEKA
Gëzim QERIMI
Lulzim AHMETI
Mergim LUSHTAKU
Sead UJKANI
Shkelzen NUZA

e-mail:

revistapaqja@gmail.com
revistapaqja@yahoo.com
revistapaqja@hotmail.com
http://www.zeri-yne.org

Adresa:

Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14, përballë teatrit Dodona, Prishtinë, Kosovë

Prishtinë

9 maj 2008



Lëvizja "Vetëvendosje" ka protestuar kundër zgjedhjeve serbe në Kosovë

Lëvizja 'Vetëvendosje' ka organizuar më 9 maj një protestë, në Prishtinë, për të kundërshtuar mbajtjen e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë. "Vetëvendosja" ka akuzuar drejtpërdrejt UNMIK-un dhe Qeverinë e Kosovës për lejimin e organizimit dhe ngritjes së strukturave paralele serbe.


Protestuesit kanë hedhur mbeturina dhe ujëra të zeza të kanalizimit në ndërtesën e UNMIK-ut, duke ia hedhur fajin për lejimin e organizimit të këtyre zgjedhjeve. Ndërkohë që po njësoj është vepruar edhe ndaj Qeverisë së Kosovës, duke e akuzuar atë se po pajtohet me gjithçka që i servohet nga Serbia dhe UNMIK-u.

Lideri i Lëvizjes 'Vetëvendosje', Albin Kurti, ka thënë se UNMIK-u dhe Qeveria e Kosovës, me vetë faktin se po lejojnë mbajtjen e zgjedhjeve serbe, po lejojnë cenimin e integritetit të Kosovës. "Strukturat e Serbisë në Kosovë e kanë kontrolluar për nëntë vjet me radhë një të katërtën e territorit të Kosovës. Tash këto struktura po zyrtarizohen përmes zgjedhjeve parlamentare dhe lokale të Serbisë brenda Republikës së Kosovës. Pas 11 majit, në 23 komuna të vendit do të ketë kryetar paralel", iu drejtua masës Kurti.

Prishtinë

10 maj 2008

Kosova ka 2.1 milion banorë





Në bazë të një raporti të publikuar nga Enti i Statistikave, në Kosovë jetojnë 2.1 milionë banorë. Sipas raportit, papunësia është 45 për qind. Në këtë raport janë përfshirë edhe të dhëna për shëndetësinë, arsimin, kulturën e fusha të tjera.

Në raportin e Entit të Statistikave, "Kosova në shifra 2007" thuhet se në Kosovë jetojnë 92 për qind shqiptarë dhe 8 për qind pjesëtarë të grupeve tjera etnike.

Raporti përfshin çështjet socio-ekonomike, demografike dhe bujqësore për vitin 2007. Në raport përfshihen edhe të dhëna për të punësuarit, të papunët, pagat, ecuritë e çmimeve, informacione për fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës etj. Sipas këtyre të dhënave, 33 për qind të popullsisë e përbën grupmosha prej 0 deri në 14 vjeç, 61 për qind prej 15 deri në 64 vjeç, kurse 6 për qind e popullatës është mbi 65 vjeç.

Për shkallën e papunësisë thuhet se rreth 45 për qind e popullatës, në moshë pune, është e papunësuar.

Shifrën prej 45 për qind të papunëve e ka paraqitur edhe Banka Botërore. Sipas një raporti të Bankës botërore, 45 për qind e popullatës në Kosovë përballet me varfërinë, ndërsa 15 për qind e saj jeton në varfëri të skajshme.

Kinë

12 maj 2008



Një tërmet i fuqishëm godet Kinën 10 mijë të vdekur vetëm në një qytet

Të paktën 10 mijë njerëz kanë mbetur të varrosur nën rrënoja, në qytetin Mianzhu, pas tërmetit më të rëndë në dekada me radhë, që ka goditur Kinën.

Tërmeti i shkallës 7.8 të Rihterit ka goditur më 12 maj jugperëndimin e Kinës, duke shkaktuar shumë viktima në njerëz dhe dëme materiale.

Media shtetërore ka njoftuar tashmë për 10 mijë të vdekur në zona të tjera të provincës Sishuan, por agjencia e lajmeve Hsinhua ka thënë se ky numër ka të ngjarë të jetë më i lartë.

Po sipas njoftimeve, në pika të tjera të provincës Sichuan, rreth 900 nxënës të dy shkollave fillore kanë mbetur të varrosur nën rrënoja.

Konfuzion i ri, iluzione të vjetra



Milazim KRASNIQI

Zgjedhjet parlamentare dhe lokale të Serbisë, që u mbajtën më 11 maj, kanë dhënë një rezultat që është shprehje e besnike e konfuzionit dhe e konfliktualitetit që është shtresuar ndër vite në shoqërinë serbe. Falë infuzionit që i dha Bashkimi Evropian fushatës së të ashtuquajturave "forca proeuropiane", koalicioni "Për Serbinë Evropiane" i udhëhequr nga kryetari i Serbisë, Boris Tadiqi, korri fitore në këto zgjedhje. Por fitorja e arritur është e pamjaftueshme për formimin e një qeverie proeuropiane e madje qoftë dhe vetëm të një qeverie, që nuk është e lidhur me fije të forta me të kaluarën e errët nacionalfashiste. Sipas ndarjes së numrit të ulëseve në Kuvendin e ri serb, blloku i Tadiqit mund ta formojë qeverinë vetëm nëse arrin marrëveshje me Partinë Socialiste të Serbisë, ose nëse sërish bashkohet me Vojisllav Koshtunicën. Në rastin e parë, qeveria do të formohej falë partisë së formuar dhe të drejtuar deri në fund të jetës së tij, nga kasapi i Ballkanit, Sllobodan Millosheviqi. Partia Socialiste e Serbisë, edhe sot e kësaj dite mban në gjirin e saj gjithë bërllokun nacionalfashist, i cili udhëhoqi katër luftëra agresive ndaj popujve të ish federatës së Jugosllavisë. Kjo parti nuk është distancuar me asnjë fjalë të vetme nga trashëgimia politike, ideologjike dhe kriminale e ish themeluesit dhe drejtuesit të saj famëkeq. Për të qenë ironia edhe më e madhe, në koalicion me këtë parti është edhe Partia Komuniste e Jugosllavisë, që e mban veten si vazhduese e trashëgimisë së ish LKJ-së famëkeqe. Me këtë trashëgimi dhe me ato struktura të pareformuara, hyrja e saj në një qeveri "proevropiane", do të ishte një ironi. As optimizmi iluzor i Havier Solanës dhe i Dimitrij Rupelit, nuk do të mund ta neutralizonin shijen e hidhur të këtij kokteji kurëbues.

Nëse do të formohej qeveria e re në koalicion me Vojisllav Koshtunicën, ajo nuk do të ishte as qeveri proeuropiane, as reformiste, por një qeveri nacionaliste dhe me konflikte të programuara brenda vetë partnerëve të koalicionit. Edhe pse Koshtunica tashmë ka deklaruar se nuk i shkon ndër mend të bashkohet sërish me Tadiqin, ka zëra që thonë se presioni i Rusisë mbi të po rritet, në mënyrë që ai sërish të mbetet në lojë dhe të bashkohet me Tadiqin. Rusisë i duhet Koshtunica në qeveri, që t'i thellojë politikat e veta ekonomike në Serbi, ku tashmë ka blerë disa nga kompanitë më të mëdha. Koshtunica i duhet në qeveri edhe që të thellojë politikat minuese ndaj Perëndimit, duke luajtur me kartën e Kosovës. Nëse janë të sakta këto pohime për idenë ruse që Koshtunica të ribashkohet me Tadiqin, atëherë është shumë e mundshme që të pranohet prej tyre këshilla e "Vëllait të Madh".

Skenari tjetër, është ai në të cilin forcat nacionaliste, të drejtuara nga Partia Radikale Serbe, do të formojnë qeverinë e re. Këtë e ka paralajmëruar zëvendëskryetari i kësaj partie, Tomisllav Nikoliqi, i cili tashmë i ka filluar negociatat me Koshtunicën. Nëse e marrin me vete edhe Partinë Socialiste, ata e krijojnë shumicën parlamentare. Mirëpo, presidenti i Serbisë, ka



kërcënuar se nuk do të lejojë formimin e një qeverie të tillë. Në atë rast, pra nëse blloku nacionalist e krijon shumicën parlamentare dhe, nga ana tjetër, bllokohet nga presidenti, rruga e vetme për ta zhbllokuar krizën mbetet lufta civile në Serbi. Këtë mundësi e ka përmendur Tomisllav Nikoliqi, në një kontekst të tërthortë, por e ka përmendur.

A është e mundshme që të ndodhë konflikt civil në Serbi? Rreziku i tij është real, për disa arsye. E para, blloku nacional-fashist, që përbëhet nga Partia Radikale e Sheshelit, Partia Demokratike e Serbisë e Koshtunicës, Partia Serbia e Re e Iliqit dhe Partia Socialiste e Serbisë, kanë fituar shumicën e votave në zgjedhjet parlamentare të 11 majit. Këto parti kanë resurse të mëdha të parave të plaçkitura dhe të armëve, si dhe vullnetarët e luftërave të kaluara në hapësirat e ish Jugosllavisë, që janë trup elektoral i tyre. Këto struktura nuk e lëshojnë lehtë istikamin, sepse orientimi evropian i Serbisë i çon ato drejt shkatërrimit gradual. Ato forca kanë vrarë në pikë të ditës ish kryeministrin e Serbisë, Zoran Gjingjiqin.

E dyta, Rusia është involvuar thellë në politikat serbe dhe me influencat në Serbi, ajo ka hapësira të ushtrimit të presionit mbi Ballkanin dhe mbi Evropën. Por, nëse për shkak të ambicieve të shtuara për ndikim, i humb ekuilibrat, (nëse e përkrah bllokun nacionalist), mund të bëhet shkaktare e eksplodimit të brendshëm të vetë Serbisë.

E treta, barrikadimi i Serbisë në politikën në drejtim të Kosovës, nuk mund të zhbllokohet pa një tërmet të madh politik e ideologjik në vetë Serbinë. Pa e marrë edhe vetë Serbia faturën e luftërave shkatërrimtare, qytetarët e saj nuk do ta kuptojnë se çfarë tragjedish u kanë shkaktuar kroatëve, boshnjakëve e shqiptarëve të Kosovës dhe se duhet të heqin dorë nga iluzionet e Serbisë së Madhe.

Megjithatë, ende mund të pengohen skenarët e tillë nga politikanët serbë, të cilët sado kokëngjeshur e fanatikë që janë, e dinë se një konflikt i përgjakshëm civil në Serbi, do t'i fshinte edhe ata nga harta politike e vendit të tyre.

Sa i përket Kosovës, rezultati i këtyre zgjedhjeve dhe epilogu i tyre, esencialisht nuk do të thotë asgjë. Përveç Partisë Liberaldemokratike, e cila mezi hyri në parlament, partitë e tjera flasin me një zë, kundër Kosovës së pavarur. Prandaj, Kosova do të vazhdojë të jetë e kërcënuar nga politikat subversive të të gjithë qeverive që do të formohen në Beograd. Kosova do të jetë e kërcënuar nga ndarja territoriale, nëse qeverinë e formon koalicioni i Tadiqit. Por, Kosova do të jetë e kërcënuar edhe nga akte subversive dhe terroriste në brendësi të saj, nëse fitojnë forcat nacionalfashiste të Sheshelit. ■

Jeta në "zonën e errët" në veri të Mitrovicës, aty ku nuk reflektohet pavarësia e Kosovës

"Kodra e minatorëve" rrezikon të mbetet pa asnj

"Kemi ndryshim të madh të strukturës etnike. Për dhjetë vjet këtu s'ka pasur qarkullim të lirë. Kushtet kanë qenë tejet të vështira për jetë, s'kemi pasur përkrahje nga askush, kështu që shumica e shqiptarëve i shitën shtëpitë e tyre dhe pas shpërnguljes së një familjeje shqiptare, në shtëpinë e tyre janë vendosur dy apo tri familje serbe. Prandaj kemi një diferencë të tillë në strukturën etnike" – thotë përfaqësuesi i shqiptarëve të kësaj lagjeje, Driton Gërguri.



Florije ADEMI

Në cepin jugor të urës kryesore mbi lumin Ibër, është stacioni i autobusit që transporton banorët e lagjes veriore "Kodra e Minatorëve", e cila konsiderohet me plot të drejtë e vetmja enklavë shqiptare në Kosovë.

Ora 7 e mëngjesit shënon orarin fillestar të qarkullimit të këtij autobusi që, në këtë kohë, ka udhëtarë kryesisht mësimdhënësit dhe punëtorët e ambulancës së lagjes.

Në pamundësi që të qarkullojë nëpër këtë urë që ka pak kilometra nga lagja, për shkak të situatës në veri, autobusi qarkullon nëpër qendër të qytetit të Mitrovicës duke shfrytëzuar urën lindore mbi Ibër që shpie në "Lagjen e Boshnjakëve", ku ndalet për të pritur patrullën e stacionit policor të veriut, e cila që nga tensionimi i situatës pas pavarësisë së Kosovës, e përcjell autobusin deri në lagje.

Banorët, por edhe mësimdhënësit, thonë se ndodh të presin 10-15 minuta policinë, derisa atyre t'u teket ta kryejnë punë që kanë marrë përsipër dhe të vazhdojnë rrugën për në lagje.

Sidoqoftë transporti i tyre në këtë kohë është shumë më i mirë se ai i viteve të para të pasluftës, kur ata janë dërguar nga KFOR-i me kamion të mbuluar, pa parë dritë me sy, derisa kanë arritur atje.

Në hyrje të lagjes, në anën e majtë, ndodhen kontejnerët e improvizuar në klasë për mësim. "Këtu vijojnë mësimin aktualisht 32 nxënës, me të cilët punojnë tetë arsimtarë, të cilët udhëtojnë nga pjesa jugore e qytetit" – thotë arsimtarja Vetone Veliu.

Në klasën e shtatë vijojnë mësimin vetëm katër nxënës, po kaq ka edhe në klasën e tetë. Ndërkaq, në klasën e gjashtë janë pesë nxënës, të tjerët janë të ciklit të ulët dhe për shkak të numrit shumë të vogël mësojnë në klasa të kombinuara, e para me të tretën dhe e dyta me të katërtën.

"Kemi pasur 60 nxënës në këtë paralele të ndarë, mirëpo me shpërnguljen e popullatës numri i nxënësve ka zbritur" – thotë arsimtarja Veliu.

Mësimi këtu fillon në orën 7.30 dhe mësimdhënësit pavarësisht nga orët e mësimit duhet të qëndrojnë në lagje deri në orarin e dytë të qarkullimit të autobusit, i cili arrin në 11.30, ose ta bëjnë zemrën "gur" e të nisen këmbë, siç ndodh me disa nga ta.

Këto klasa janë paralele e ndarë e Shkollës Fillore "Aziz Sylejmani" që ndodhet në veri. Nxënësit e kësaj shkolle mësojnë aktualisht në objektet e shkollës fillore "Muharrem Bekteshi" në jug të qytetit, e cila është e stërngarkuar, pasi aty vijojnë mësimin edhe nxënësit e shkollës "Nonda Bulka", e cila po ashtu ndodhet në veri të qytetit.

Flamur Gacaferri, drejtori i shkollës "Aziz Sylejmani", thotë se telashet e tyre në lidhje me objektin kanë filluar qysh në vitin 1990-91, kur nxënësit dhe



Nxënësit e klasës së IV-t gjatë orës së

ë banor shqiptar

mësimdhënësit shqiptarë janë përzënë nga objekti i tyre shkollor.

"Fillimisht kemi punuar nëpër shtëpi private, pastaj jemi vendosur në ndërtesën e vjetër të shkollës "Nonda Bulka, për të vazhduar më pas në objektin e shkollës 'Muharrem Bekteshi". Ndërkaq, nxënësit e "Kodrës së minatorëve", janë detyruar për shkak të rrethanave që të vijojnë mësimet në objekte të improvizuara, fillimisht deri në klasën e katërt, ndërsa më pas për shkak të mungesës së transportit, në pajtim me drejtorinë e arsimit në Mitrovicë, mësimi ka vazhduar atje deri në klasën e tetë, kurse këtë vit pritet që të fillojë edhe klasa e nëntë".

Përkundër vështirësive të shumta dhe ndarjes në paralele, kjo është një ndër shkollat më të mira të qytetit të Mitrovicës.

mësimit

Sa i përket paraleles së ndarë në "Kodrën e Minatorëve", përfaqësues të drejtorisë së arsimit në Mitrovicë kanë premtuar ndërtimin e një objekti shkollor gjatë këtij viti.

Drejtori Gacaferri pohon se janë njoftuar se është shpallur tenderi, është zgjedhur përfituesi dhe pritet që të fillojë puna në këtë drejtim.

Gërguri: nga 230 familje shqiptare kanë ngelur vetëm 73 familje.

Në afërsi të shkollës së improvizuar ndodhet ambulanca. Përfaqësuesi i shqiptarëve të kësaj lagjeje, Driton Gërguri, thotë se çdo ditë aty shkon mjeku i përgjithshëm, ndërkaq njëherë në javë edhe mjeku i fëmijëve.

Por, fatkeqësisht, këta banorë nuk "guxojnë" të sëmuren pas orës 11.30, kur përfundon orari i punës së mjekut të përgjithshëm, e as të dielave kur mjeku nuk punon fare.

Sipas Gërgurit, pas luftës në këtë lagje kanë jetuar 230 familje shqiptare, ndërsa familjet serbe numëroheshin në gishta. Ndërkaq, tani janë vetëm 73 familje shqiptare, kurse numri i familjeve serbe të vendosura aty thuhet të jetë mbi 200.


Kontenjerët e improvizuar në klasë për mësim

"Kemi ndryshim të madh të strukturës etnike. Për dhjetë vjet këtu s'ka pasur qarkullim të lirë. Kushtet kanë qenë tejet të vështira për jetë, s'kemi pasur përkrahje nga askush, kështu që shumica e shqiptarëve i shitën shtëpitë e tyre dhe pas shpërnguljes së një familjeje shqiptare, në shtëpinë e tyre janë vendosur dy apo tri familje serbe. Prandaj kemi një diferencë të tillë në strukturën etnike" – thotë përfaqësuesi i shqiptarëve të kësaj lagjeje, Driton Gërguri.

Ai vlerëson se në çdo aspekt, qoftë moral, shpirtëror, fizik apo psikik, jeta në këtë lagje është e vështirë. Çdoherë njerëzit ndihen nën ankth se çka do të bëhet.

Ndonëse pranon se kanë pritur shumë nga pavarësia e Kosovës, sipas tij, shenjat e saj nuk vërehen në këtë lagje, që ai e quan "zonë e errët", apo "zonë kancer" në pjesën veriore të këtij qyteti, e cila mbikëqyret nga struktura të ndryshme politike, policore, mafioze, paramilitare…

"Nëse vazhdohet me këtë trend të mospërkujdesjes ndaj banorëve nga ana e institucioneve, gjë që po shkakton edhe shitjen e pronave shqiptare, ekziston rreziku i spastrimit etnik" – thotë Gërguri, duke shtuar se deri më tani nuk është investuar as për qëndrimin e atyre banorëve në lagje, e as për kthimin e të tjerëve aty.

"Çdo ndryshim i gjendjes vërehet në këtë lagje, në Bistricë të Leposaviqit, Zhazhë të Zveqanit, etj. Kemi menduar se pas pavarësimit të Kosovës do të përmirësohet kuptimi i fjalës jetë në këto anë, por as që po vërehet një gjë e tillë".

"Gjendja ekonomike e sociale e banorëve të lagjes sonë është tejet e rëndë, shumica, mos të them të gjithë të rinjtë, janë të papunë, përveç disave që punojnë privatisht kur gjejnë punë fizike për ndonjë ditë. Askush nuk investon as për rindërtimin e disa shtëpive, të cilat banorët edhe po të donin t'i shitnin nuk do të mund t'i shitnin as nga 10 mijë euro dhe me këto të holla nuk do të mund të blinin objekte banimi askund..." - thotë Gërguri.

Me gjithë vështirësitë e jetesës, nga mosdëshira e tyre për ta lëshuar lagjen këto familje vazhdojnë të jetojnë aty, por e ardhmja e tyre varet nga interesimi i institucioneve tona për ta. ■

Intervistë me dr. Hysen Matoshin, ushtrues i detyrës së drejtorit të Institutit Albanologjik të Prishtinës

Përkujdesja për kulturën tonë kombëtare është lënë pas dore

- Në planin e punës për vitin 2008 janë përfshirë 41 projekte individuale dhe 8 projekte të përbashkëta;
- Puna kërkimore në terren është rrëgjuar shumë si pasojë e mungesës së mjeteve financiare;
- Instituti Albanologjik dhe përgjithësisht shkenca në Kosovë, deri tani nuk janë trajtuar si duhet;
- Kërkesat tona për kuadër të ri hasin në veshë të shurdhër.

Intervistoi: Demir RESHITI

Instituti Albanologjik, që është ndër institucionet më të hershme studimore në botën shqiptare, sivjet kremton 55 vjetorin e themelimit. Për t'u njohur me punën, të arriturat dhe vështirësitë me të cilat po ballafaqohet ky institucion shkencor, zhvilluam një intervistë me prof. dr. Hysen Matoshin, ushtrues i detyrës së drejtorit të këtij Instituti. Dr. Matoshi shpreh brengosjen e tij se përkujdesja për kulturën tonë kombëtare dhe studimi i saj është lënë pas dore. Ai është i mendimit se duke e shpërfillur trashëgiminë tonë tepër të veçantë kulturore, po e humbim vlerën si komb dhe po e nënçmojmë identitetin tonë...

Prof. dr. Hysen Matoshi u lind më 31.7.1967 në fshatin Gmicë të Dardanës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Prishtinë, ndërsa studimet në Degën e Letërsisë dhe të Gjuhës Shqipe pranë Fakultetit Filozofik të Prishtinës. Pas diplomimit ka punuar mësimdhënës në shkollën fillore të vendlindjes dhe në ato të mesme të Dardanës, deri në zgjedhjen e tij praktikant në Degën e Letërsisë së Institutit Albanologjik të Prishtinës. Më 1997 ka mbrojtur magjistraturën "Poezia e Lasgush Poradecit në kontekstin e poezisë evropiane", ndërsa më 2005 ka mbrojtur tezën e doktoratës "Stilet në poezinë shqipe ndërmjet dy luftërave botërore". Një periudhë të shkurtër ishte shef i Degës së Letërsisë, ndërsa tani është ushtrues i detyrës së drejtorit të Institutit Albanologjik të Prishtinës, këshilltar shkencor në Degën e Letërsisë dhe ligjërues në Fakultetin e Edukimit të UP-së.
Prof. dr. Hysen Matoshi ka botuar librat: 'Poezia e Lasgush Poradecit në kontekstin e poezisë evropiane' (2000), 'Shqyrtime letrare' (2005), ndërsa sivjet në planin e botimeve të IAP-it është përfshirë libri i tij 'Stilet në poezinë shqipe ndërmjet dy luftërave botërore'. Gjithashtu, ka botuar rreth njëqind njësi bibliografike (studime, recensione, shkrime publicistike, ese etj.) në periodikun shkencor dhe në shtypin shqip të Kosovës, të Shqipërisë dhe të Maqedonisë.
Prof. dr. Hysen Matoshi ka marrë pjesë në dhjetëra aktivitete të ndryshme shkencore (konferenca, simpoziume, sesione, tryeza, promovime veprash etj.) të organizuara në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni.



Në planin e punës për vitin 2008 janë përfshirë 41 projekte individuale dhe 8 projekte të përbashkëta

PAQJA: ***Cili është statusi i shkencës te ne sot, në mënyrë të veçantë i shkencave albanologjike?***

Matoshi: Mund të thuhet se rrjedhat e përgjithshme shoqërore në Kosovë reflektohen pashmangshëm edhe në statusin e shkencës, si veprimtari me interes. Në një shoqëri të zhvilluar, pjesëmarrja e shkencës në rrjedhat e saj, roli dhe rëndësia e saj për përcaktimin e rrugëve zhvillimore janë vendimtare. Fatkeqësisht, shkenca, në një vend që përballet me një tranzicion të stërzgjatur, siç është Kosova, e ka të vështirë që ta përmbushë qëllimin e saj. Duke mos qenë, në pjesën më të madhe, kreatorë të arritjeve shkencore, ne shpesh mbesin prapa edhe për sa i përket njohjes së arritjeve në këtë fushë. Nëse mund të thuhet se për të qenë pjesë e krijimit të teknologjisë së përparuar botërore është i nevojshëm një tjetër stad i zhvillimit ekonomik, kjo gjë nuk mund të pohohet krejtësisht edhe për ngecjet në fushën e studimeve albanologjike. Thënë të drejtën, në këtë drejtim gjendja është disi më e mirë, por gjithsesi jo e nivelit të kënaqshëm. Brengos, sidomos, fakti se gjithnjë e më pak shohim albanologë të rinj, se përkujdesja për kulturën tonë kombëtare dhe studimi i saj është lënë pas dore. Druaj se, duke e shpërfillur trashëgiminë tonë tepër të veçantë kulturore, po e humbim vlerën si komb, po e nënçmojmë identitetin tonë.

PAQJA: ***Sivjet Instituti Albanologjik po bën 55 vjet nga themelimi i tij. Cilat janë projektet më të rëndësishme që po punohen aktualisht?***

Matoshi: Instituti Albanologjik është ndër institucionet më të hershme studimore në botën shqiptare dhe, pa dyshim, i pari institucion shkencor shqiptar i themeluar në ish-Jugosllavi. Për rëndësinë e tij, më shumë se kjo periudhë gjysmëshekullore e ekzistimit,

flasin rezultatet, vërtet, inkurajuese. Megjithëse kanë punuar në rrethana tepër të vështira të mohimit rankoviqian, të diferencimit ideo-politik që bëhej nga LKJ-ja, të dëbimit me dhunë nga objekti, të mohimit nga një pjesë e faktorit ndërkombëtar, të shpërfilljes e të nëpërkëmbjes nga disa struktura tona qeverisëse, punonjësit shkencorë të Institutit Albanologjik kanë bërë shumë për ruajtjen, studimin dhe afirmimin e kulturës sonë kombëtare. Rreth 400 vëllime me materiale e me studime albanologjike tregojnë një punë të denjë për respekt. Në planin e punës për vitin 2008 janë përfshirë 41 projekte individuale dhe 8 projekte të përbashkëta. Në kuadër të tyre studiohen gjuha, letërsia, historia, folklori dhe etnologjia shqiptare.

PAQJA: ***Po në planin e botimeve, çfarë mund të presim sivjet nga IAP-i?***

Matoshi: Sa u përket botimeve, them me bindje të plotë se financimi nga Qeveria e Kosovës nuk i përcjell ritmet e prurjeve shkencore të albanologëve të Institutit tonë. Për rrjedhojë, kemi një numër më të madh të projekteve që presin me vite ta shohin dritën e botimit. Vetëm sivjet kemi paraparë botimin e 36 vëllimeve. Duke e ditur se buxhet të ndarë enkas për veprimtarinë botuese nuk kemi dhe se botimet i financojmë nga kode të tjera buxhetore (rreth 70 mijë euro që menaxhohen nga Instituti), ne kemi bërë një plan botues ku parashohim që t'u japim përparësi revistave tona shkencore, monografive, përmbledhjeve me materiale albanologjike të vjela në terren, në arkiva, etj. Gjithsesi, përveç tri serive të "Gjurmimeve albanologjike" dhe tri numrave të revistës "Gjuha shqipe" shpresojmë që të mund t'i botojmë edhe monografitë e punonjësve: Mehmet Halimi, Naser Pajaziti, Shefkije Islamaj, Qemal Murati, Rexhep Qosja, Resmije Kryeziu, Sadri Fetiu, Zymer Neziri, Zekerija Cana, Muhamet Pirraku, Lulzim Lajçi, Lush Culaj etj., por mbesin edhe vëllime me materiale nga sesione shkencore, pastaj me materiale folklorike, përmbledhje studimesh të punonjësve tanë... Risi e planit të sivjetshëm botues do të mund të konsiderohej fillimi i botimit të revistës "Gjurmime albanologjike" në anglisht, si një nevojë e komunikimit të rezultateve tona shkencore në një "treg" më të gjerë dijesh. Kur e kemi fjalën për planin botues, vlen të theksohet se Instituti në vijimësi ka botuar vepra të bashkëpunëtorëve të jashtëm. Kështu, sivjet, deri tani, kemi botuar katër libra të autorëve të këtillë.

Puna kërkimore në terren është rrëgjuar shumë, si pasojë e mungesës së mjeteve financiare

PAQJA: ***Çfarë aktivitetesh shkencore ka paraparë Instituti për sivjet?***

Matoshi: Në planin tonë të punës një vend të rëndësishëm e zënë edhe aktivitetet shkencore. Sivjet janë paraparë një numër sish. Kështu, Dega e Gjuhësisë tashmë e ka realizuar sesionin e paraparë shkencor kushtuar dyzetvjetorit të Konsultës Gjuhësore të Prishtinës, në të cilin kanë marrë pjesë më se 30 referues nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia; Dega e Folklorit dhe ajo e Etnologjisë kanë paraparë organizimin e një sesioni kushtuar veprës së etnomuzikologut Ramadan Sokoli, i cili sivjet u nda nga jeta; Dega e Historisë do ta organizojë një sesion shkencor kushtuar Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës; Dega e Letërsisë për këtë vit ka paraparë zhvillimin e disa tribunave shkencore. Gjithashtu, me subjekte të tjera shkencore, kulturore e shoqërore do të organizojmë simpoziumin shkencor kushtuar 40-vjetorit të demonstratave të 68-s, ndërkohë si institucion shkencor marrim pjesë edhe në organizimin e aktiviteteve për nder të 100-vjetorit të Kongresit të Manastirit. Megjithatë, duhet thënë se përveç këtyre aktiviteteve, në të cilat jemi organizatorë ose bashkorganizatorë, punonjësit tanë do të marrin pjesë edhe në aktivitete shkencore që organizohen nga të tjerët, si bie fjala, seminari i Prishtinës, ai i Tetovës etj.

PAQJA: ***Sa mbështeten materialisht kërkimet shkencore?***

Matoshi: Kërkimet shkencore, jo për fajin e albanologëve, janë bërë thembër e Akilit në aktivitetet tona. Puna kërkimore në terren, në arkiva e në biblioteka, e cila dikur ishte ndër shtyllat e aktivitetit shkencor, është rrëgjuar shumë, si pasojë e mungesës së mjeteve financiare për këtë qëllim. Dikur Instituti organizonte ekspedita hulumtuese në terren dy herë në vit, ndërsa sot e kemi të vështirë që të sigurojmë mbështetje qoftë edhe disaditore terreni për punonjësit tanë. Veçmas dialektologët, folkloristët, arkeologët dhe etnologët nuk mund të bëjnë punë të mirëfilltë shkencore pa eksplorimin e terrenit. Jo më pak i rëndësishëm është



gjurmimi nëpër arkiva e biblioteka, sidomos kur është fjala për ato të Shqipërisë.

Instituti Albanologjik dhe përgjithësisht shkenca në Kosovë, deri tani nuk janë trajtuar si duhet

PAQJA: ***Cili është bashkëpunimi i Institutit Albanologjik me institucionet e tjera shkencore në vend dhe jashtë tij?***

Matoshi: Bashkëpunimi me institucionet shkencore, arsimore e kulturore të Kosovës është zhvilluar në vijimësi. Të theksojmë se bashkëpunim kemi me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, me Institutin e Historisë, me Fakultetin e Filologjisë të UP-së, me Lidhjen e Shkrimtarëve të Kosovës, me Shoqatën e Gjuhës etj. Instituti Albanologjik bashkëpunon edhe me institutet përkatëse të Tiranës, sikundër janë Instituti i Kulturës Popullore, Instituti i Gjuhësisë e i Letërsisë dhe Instituti i Historisë ka qenë tepër i rëndësishëm për rezultatet e albanologjisë përgjithësisht. Ka pasur shumë aktivitete të përbashkëta shkencore, të cilat kanë shërbyer në aspektin e pasurimit të ndërsjellë me përvoja studimore. Punimet e punonjësve të të dyja vendeve janë botuar në revistat gjegjëse të instituteve, por janë organizuar edhe ekspedita të përbashkëta hulumtuese në terren, në Kosovë e në Shqipëri, me pjesëmarrjen e punonjësve të gjuhësisë, të folklorit e të etnologjisë të Institutit Albanologjik dhe të instituteve të Tiranës. Punohet edhe në projekte konkrete, siç është ai për terminologjinë e fushës së folklorit. Instituti Albanologjik është përfshirë edhe në Protokollin e bashkëpunimit ndërmjet Akademisë së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë me projekte të caktuara. Në këtë pikëpamje si një zhvillim pozitiv do ta çmoja edhe themelimin e institutit albanologjik në Shkup, me çka po krijohet edhe një dritare e afirmimit dhe e studimit të kulturës shqiptare.

PAQJA: ***Pas ndryshimeve në kreun e Ministrisë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, a prisni të ndryshojë qasja ndaj institucionit tuaj?***

Matoshi: Instituti Albanologjik, por përgjithësisht shkenca në Kosovë, deri tani nuk janë trajtuar si duhet. Përveçse nuk ka pasur mbështetje të duhur materiale, albanologët jo rrallë janë shpërfillur dhe madje dinjiteti i tyre edhe është nëpërkëmbur. Tani në krye të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë kemi një personalitet nga bota akademike dhe mbi të gjitha një njeri që i kupton drejt kërkesat e zhvillimit modern të shkencës. Ministri Enver Hoxhaj dhe ekipi i tij kanë premtuar se do të ndihmojnë që gjendja të ndryshojë rrënjësisht në këtë drejtim.

Kërkesat tona për kuadër të ri hasin në veshë të shurdhër

PAQJA: ***Si qëndron puna me kuadrin në Institutin Albanologjik?***

Matoshi: Çështja e kuadrit përbën një problem të mprehtë për punën e mëtejme e të suksesshme në këtë institucion me traditë. Ka vite që kërkesat tona për kuadër të ri hasin në veshë të shurdhër. Numri i punonjësve shkencorë për pak kohë është zvogëluar për dhjetë sish, ndërsa trendi i daljes në pension në IAP është tepër shqetësues nga pikëpamja e zëvendësimit të tyre me kuadro të reja. Krijimi i një shkencëtari, sikundër dihet, kërkon kohë dhe punë afatgjate. Për tre vjet nuk është zgjidhur as statusi i pesë punonjësve të rinj të pranuar me konkurs. Ne besojmë se përtëritja e kuadrit do të jetë njëra ndër çështjet që do ta gjejë mbështetjen e MASHT-it. Gjithsesi, këtë gjendje sadopak e ka zbutur angazhimi i punonjësve tashmë të pensionuar të IAP-it, të cilët, megjithëse ka vite që nuk paguhen më nga buxheti i Kosovës, i kanë vazhduar punët për realizimin e një numri të konsiderueshëm projektesh.



PAQJA: ***Përveçse me punët e menaxhimit, në çfarë projekti jeni i angazhuar si punonjës shkencor i Institutit Albanologjik?***

Matoshi: Si punonjës shkencor në Degën e Letërsisë, pas përfundimit të dy projekteve, jam duke e vazhduar punën në projektin 'Letërsia shqipe 1939-1944'. Menaxhimi është një punë tejet kërkuese, por po bëj përpjekje që të mos mbetem prapa në realizimin e projektit tim. Po ashtu, sivjet e kam në planin botues studimin monografik 'Stilet në poezinë shqipe ndërmjet dy luftërave botërore'.

PAQJA: ***Për fund, cili do të ishte mesazhi i juaj për lexuesit e revistës "Paqja".***

Matoshi: Fillimisht dua ta përshëndes redaksinë e revistës suaj, duke konsideruar se me punën e deritanishme, me përmbajtjen e larmishme, e keni pasuruar ndjeshëm, e me vlera të qëndrueshme, ambientin tonë medial e kulturor. Uroj të arrini edhe më shumë. Çfarë do të mund t'u thoshte lexuesve tuaj një njeri, që pjesën më të madhe të kohës e kalon duke lexuar, përveç porosisë që të vazhdojnë të pasurohen duke lexuar. Them se paqen shpirtërore, pa dyshim, do të mund ta gjejnë, më mirë se kudo tjetër, në lexim. ■

Korrespodencë nga Shkupi

Kush do t'i fitojë zgjedhjet në Maqedoni?

Në kontekstin e përgjithshëm, shpeshherë ka ndodhur që zgjedhjet nuk kanë ofruar zgjidhje, ose janë gjetur zgjidhje pa pasur zgjedhje dhe, po ashtu, ka rastisur që edhe pas zgjedhjeve të dëshiruara nuk ka pasur zgjidhje të kënaqshme.



Avni AVDIU

Zgjedhje dhe zgjidhje...Çdoherë që afrohen zgjedhjet, shtohen gjasat që të ngatërrohen këto dy nocione. Për fat të keq ngatërrimi i tyre ndodh në të gjitha mediat pa përjashtim – si në ato elektronike ashtu edhe në ato të shkruara, madje në një përqindje të madhe përdorimi. Edhe pse këto dy nocione dallojnë pak për nga veçoria fonetike dhe ortografike me vetëm një zanore, prapëseprapë dallimi konceptual në mes tyre është shumë më i thellë dhe më i ndërlikuar. Të zgjedhësh do të thotë të vendosësh, të caktosh, të veçosh, të shkoqitësh dhe të marrësh një, ose disa, nga një numër i konsiderueshëm i mundësive që të ofrohen. Ndërkaq të zgjidhësh do të thotë të kryesh ose të përfundosh një problem, duke hequr njëherësh pengesat që e kanë shkaktuar atë. Mirëpo, ky dallim në rrafshin politik shtron edhe dilema tjera. A mund të këtë zgjidhje pa zgjedhje…a mund të ketë zgjedhje pa zgjidhje dhe pas zgjedhjeve, nëse do të ofrohet ndonjë zgjidhje, atëherë a do të jetë ajo zgjidhje adekuate, mu ashtu siç dëshirohej gjatë zgjedhjeve?!

Për të gjetur përgjigje për këto pyetje duhet shqyrtuar çdo rast e situatë veçmas, por në kontekstin e përgjithshëm shpeshherë ka ndodhur që zgjedhjet nuk kanë ofruar zgjidhje, ose janë gjetur zgjidhje pa pasur zgjedhje dhe, po ashtu ,ka rastisur që edhe pas zgjedhjeve të dëshiruara nuk ka pasur zgjidhje të kënaqshme.

Sondazhomania...

Ende pa filluar zyrtarisht fushata parazgjedhore në Maqedoni, partitë kryesore shqiptare PDSH në pozitë dhe BDI në opozitë kanë shkëmbyer akuza dhe kundërakuza reciproke, përkitazi me disa incidente të ndodhura te të dyja palët, lidhur me punësimet, disa arrestime e kështu me radhë. Një ndër pretekstet e përplasjeve verbale ishin edhe sondazhet e shumta që u zhvilluan, e që u bënë përditshmëri dhe modë. Ato nxirrnin herë njërën, e herë tjetrën, parti në epërsi.

Duke synuar të pasqyrojnë rejtingun politik të partive politike, shumësia e tyre formoi një hiper-realitet të ri në prag të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Sondazhomania ishte e pranishme në mediat e shkruara dhe elektronike, por edhe në bisedat e zakonshme ditore. Mbi të gjitha, ajo që vlen të theksohet nga e gjithë kjo fushatë sondazhesh është reagimi emocional e jo shkencor i subjekteve politike. Pala humbëse nga këto hulumtime nuk do ta pranonte disfatën kurrë paraprake, aq më tepër kur dihet se vështirë e ka ta pranojë edhe humbjen që është rrjedhë e drejtpërdrejtë e votimeve gjatë zgjedhjeve. Mu për këtë, nga reagimet partiake ndaj sondazheve, nuk është dëgjuar të preket asnjëherë karakteri epistemologjik i tyre.

Sondazhet e disfavorshme kualifikohen si joprofesionale, të porositura e të paguara, të shpifura, të dirigjuara e të instrumentalizuara nga partia rivale, që vetëm emrin e kanë hulumtim, e që në fakt janë lojë, fabrikim, manipulim, djallëzi dhe mashtrim i ulët me shifra





për interesa mediale në funksion të asaj partie. Pasi partia, që kalon dobët nga sondazhi, e hedh poshtë hulumtimin, ajo e konsideron atë të afërt me partinë që ka dalë mirë nga anketimi, duke theksuar se ai sondazh nuk pasqyron realitetin në terren dhe madje thuhet se instituti që ka kryer hulumtimin ka gabuar me ose pa dashje. Ndërkohë, secila parti që del mirë nga ndonjë sondazh, konsideron se hulumtimi ka qenë serioz, neutral dhe objektiv. Këto vlerësime a priori, nuk përkojnë aspak me qasjen shkencore ndaj sondazheve.

Është krejt e natyrshme që partitë që nuk janë të kënaqura nga rezultatet e hulumtimeve të reagojnë me gjuhën e tyre politike. Mirëpo, reagimi i partive do të ishte shumë në rregull sikur, me anë të tij, të kundërshtohej metodologjia e realizimit të këtyre hulumtimeve, pra, mostra, pyetësori, formulimi i pyetjeve, margjina e gabimit, devijimi standard, forma e prezantimit të rezultateve, etj...P.sh: do të mjaftonte vetëm një devijim i vogël në mostër, nëse disa pyetësorë barten nga zonat urbane në rurale, pastaj mënyra e zgjedhjes së të anketuarve, e të tjera kështu me radhë. Zaten duket qesharak gjithë ai siklet i sondazheve, sepse tekefundit ato janë vetëm një përqindje e realitetit, por jo një realitet shumë i sigurt, sepse proceset shoqëroro-politike janë më të thella e më komplekse, sa që nuk mund të reduktohen në shifra.



Nga aspekti epistemologjik e vërteta nuk duket bardhë e zi. Në njëfarë mënyre rastet e tilla janë sikur antinomitë e Kantit: sa ka argumente për t'i pohuar. aq ka argumente edhe për t'i mohuar. Ajo që në mënyrë përfundimtare do të vuloste besueshmërinë faktike të këtyre hulumtimeve (që përpos karakterit shkencor kanë edhe konotacion historicist, sepse në njëfarë mënyre sikur synojnë t'i parashikojnë shkencërisht rrjedhat e ardhshme sociale), do të ishte pa mëdyshje pritja e rezultatit të zgjedhjeve të ardhshme. Atëherë, po të përdorim një nocion të Karl Poperit do të ishim edhe 'praktikisht të sigurt'.

Çka do të fitojnë shqiptarët...?

Gjersa dilema e shqiptarëve në Maqedoni mbetet PDSH apo BDI, çka nëse fiton njëra e çka nëse fiton tjetra, sikur është harruar se e rëndësishme është që përpara se të shtrohen këto pyetje, më e rëndësishme është të pyesim se çka do të fitojnë shqiptarët. Mirëpo 'loja e votave' është një ndër parimet bazë të demokracisë. Mirëpo demokracia nuk duhet të kuptohet si shkop magjik, që nëse i vë në përdorim mekanizmat e saj do të bëjë çudira. Edgar Moreni, në librin e tij "Evropa në mendje", thekson me të drejtë se '…demokracia nuk është pasqyrim i një rendi hyjnor ose kozmik…e vërteta e saj themelore është mospasja e së vërtetës'.

Së këtejmi duhet hequr iluzioni se zgjedhjet dhe zgjidhja mund të interferohen, duke gjeneruar diçka që mund të jetë mrekullibërëse. Mundë të ndodh që zgjedhjet dhe zgjidhjet të ngatërrohen jo vetëm në të shkruar, në të shqiptuar e në të kuptuar, por edhe në të vepruar.

Dihet qartë se në fushatat parazgjedhore mund të thuhet gjithçka, por e rëndësishme është që ajo të jetë e arsyeshme dhe e arritshme. Nëse nuk është e tillë, atëherë ndëshkimi mund të vijë sërish nga procesi zgjedhor. Në këtë rast, demokracia do të kërkonte rrotacionin e forcave politike në pushtet, ndonëse edhe kjo s'është zgjidhje, sepse i zgjedhuri sërish mund të dalë nga kontrolli i zgjedhësve, duke mos mbajtur përgjegjësi për atë çfarë ka thënë. Rrjedhimisht, në prag të zgjedhjeve parlamentare në Maqedoni, partitë politike duhet të marrin mësim nga rastet më të freskëta. Ato duhet të jenë sa më realiste, sa më të arsyeshme dhe sa më në tokë, e jo në qiell. Duhet shkuar derë më derë për t'i dëgjuar hallet e popullit, jo për ta mashtruar atë e për t'ia vjedhur votën, por për t'u zotuar se do të jepet maksimumi për t'i dalë zot kërkesave të tij. Do të ishte rast i volitshëm që dikush të zgjohet nga nekropolitika, e dikush tjetër të vetëkonfirmohet. Ndërkaq është karakteristikë e modelimit psikokulturor tradicional te ne, që kur shihet se tjetri po bën diçka më tepër, nxirret në pah egotendenca për t'ia prerë rrugën, e prirë nga ndjenja e shpirtit konkurrues dhe dëshira për të afirmuar individualitetin vetjak.

Sido qoftë, mbi të gjitha, do të ishte njerëzore të mbillet toleranca e mirëkuptimi reciprok, që të mos ndodhin përplasje të panevojshme ndërmjet forcave me orientime të ndryshme partiake. Partitë duhet ta braktisin 'logjikën' e sharjeve, akuzave dhe zënkave, ashtu që, në vend të tyre, të ofrojnë programe cilësore, alternativa dhe projekte të dobishme. Në këtë aspekt, fushata e fundit parazgjedhore në Kosovë ishte korrekte. Prandaj, sa për fillim, partitë në Maqedoni duhet të nxjerrin dy leksione nga zgjedhjet në Kosovë: të mos bëjnë premtime të paarritshme dhe të mos merren me akuza reciproke. Do të kishte qenë e udhës që të bashkoheshin të gjithë në një koalicion kombëtar, si përgjigje ndaj kryeministrit Gruevski, i cili ka deklaruar se do të dëshironte ta arrinte kuotën 61% për të mos qenë i kushtëzuar nga partneri i koalicionit. Megjithatë, pasi kjo duket utopi, për faktin se politika e shqiptarëve në Maqedoni është më tepër politikë xhelozish (BDI) e inatesh (PDSH), atëherë, të paktën e mira më e vogël që pritet nga partitë shqiptare do të ishte të mos e polarizonin elektoratin dhe ta kursenin populli nga incidentet e mundshme. Për momentin kjo do të ishte zgjidhja më e mirë e këtyre zgjedhjeve të parakohshme. ■





Po bëhen gati pasaportat e Republikës së Kosovës

Sipas ministrit Pajaziti, pasaportat e Republikës së Kosovës janë në proces e sipër të prodhimit dhe dizajnimit të tyre dhe do të kenë standardin më të lartë të sigurisë të rekomanduar nga Komisioni i BE-së.



Bujar SEJDIU

Në korrik, pritet të fillojë prodhimi i pasaportave dhe i dokumenteve identifikuese për qytetarët e Kosovës, që do të zëvendësojnë ato që janë lëshuar nga Unmik-u, para 9 vjetësh.

Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës ka filluar përgatitjet teknike për nxjerrjen e dokumenteve, që sipas sugjerimeve të mekanizmave ndërkombëtarë, duhet të jenë të cilësisë së lartë, ndërkohë që dokumentet e UNMIK-ut do të mbeten të vlefshme deri në skadim.

Ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës z. Zenun Pajaziti ka deklaruar për mediat se pasaportat e Republikës së Kosovës, si edhe dokumentet tjera personale, do të fillojnë t'i zëvendësojnë ato të UNMIK-ut në korrik të këtij viti. Pajaziti, po ashtu, ka bërë të ditur se prodhimi i pasaportave do të bëhet jashtë Kosovës. "Procesi i prodhimit të pasaportave do të zgjasë, pasi ato nuk do të prodhohen këtu. Është një afat 4-mujor dhe ne do të përkujdesemi që kjo periudhë të jetë përgatitore, në mënyrë që qytetarët të mos kenë më probleme, pas udhëtimit jashtë vendit" – ka thënë Pajaziti.

Pasaporta e re me vlefshmëri 10-vjeçare

Mësohet se një kompani gjermane dhe një franceze kanë marrë përsipër prodhimin e pasaportave dhe dokumenteve të tjera të udhëtimit.

"I gjithë procesi i prodhimit të dokumenteve personale do të kushtojë rreth 1 milionë e 800 mijë euro" – ka theksuar ministri Pajaziti, duke shtuar se pasaportat e Republikës së Kosovës do të jenë me ngjyrë të kaltër të mbyllur me stemën e Republikës në mes.

Për fëmijët nën moshën 3-vjeçare, afati i pasaportës do të jetë tri vjet, për qytetarët e moshës pesë deri në 27-vjeç, afati do të jetë pesë vjet, ndërkaq pasaporta me vlefshmëri 10-vjeçare do të lëshohet për personat më të vjetër se 27 vjet.

Ndërsa, deri ditën kur do të dalë në qarkullim pasaporta e Republikës së Kosovës do të vazhdojë të përdoret dokumenti i udhëtimit të UNMIK-ut.

Sipas Kushtetutës së Kosovës, qytetarëve u lejohet dyshtetësia, e kjo do të thotë se një qytetar i Kosovës mund të ketë dy pasaporta, dhe sipas ministrit Pajaziti nga kjo mund të fitojnë të gjithë qytetarët e Kosovës. Sipas tij, ende nuk është mbyllur çështja e legjislacionit dhe e përcaktimit të kritereve që duhen plotësuar nga shtetasit e huaj për të pasur pasaportën e Kosovës.

Pra, më në fund, shqiptarëve të Kosovës po ju plotësohet ëndrra e kamotshme për të pasur pasaportë të shtetit të tyre.

Dihet që serbët e Kosovës kanë përdorur, deri më tani, pasaportat serbe dhe normalisht do të vazhdojnë t'i përdorin edhe në të ardhmen, duke pasur parasysh se tashmë kjo iu lejohet edhe me Kushtetutën e Kosovës. Mbetet dilemë për shqiptarët e Kosovës se a do të pajisen edhe me pasaporta serbe, pasi edhe për ta do të jetë diçka legale, e sidomos nëse në Serbi vijnë në pushtet forcat pro-evropiane, kur dihet se shumë shtete evropiane kanë premtuar se mbajtësit e pasaportës serbe mund të qarkullojnë në Evropë pa viza fare.

Vetëm 39 shtete e kanë pranuar pasaportën e UNMIK-ut

Që nga përfundimi i luftës së fundit në Kosovë, në vitin 1999, qytetarët e Kosovës, në veçanti shqiptarët, janë përballur me pengesa për të udhëtuar jashtë vendit dhe kjo si pasojë e mungesës së pasaportave, apo dokumenteve të udhëtimit.

Edhe pas instalimit të misionit administrativ të UNMIK-ut, ky problem ka vazhduar të jetë ndër brengat kryesore të atyre që kanë pasur nevojë të udhëtojnë jashtë Kosovës. Deri kur ka filluar pajisja e qytetarëve fillimisht më letër njoftime, e pas një kohe edhe me dokumente udhëtimi (pasaporta), mundësi udhëtimi jashtë vendit kanë pasur vetëm personat me raste urgjente për shërim jashtë vendit dhe rastet diplomatike.

Në këso raste si dokument udhëtimi është përdorur thjesht një letër e bardhë, ku janë shënuar të dhënat personale, një fotografi si dhe viza e vendosur në atë "pasaportë të improvizuar".

Në anën tjetër, gjatë gjithë kohës, kanë qenë në qarkullim edhe pasaportat e ish-Federatës së Jugosllavisë, të përdorura kryesisht nga qytetarët serbë të Kosovës, por nuk ka munguar përdorimi i tyre edhe nga një pjesë e konsiderueshme e shqiptarëve. Pasaportat jugosllave janë njohur nga shumica e shteteve të botës dhe kjo ka bërë që të shtohet interesimi për këto pasaporta edhe nga shqiptarët.



"I gjithë procesi i prodhimit të dokumenteve personale do të kushtojë rreth 1 milionë e 800 mijë euro" – ka theksuar ministri Pajaziti, duke shtuar se pasaportat e Republikës së Kosovës do të jenë me ngjyrë të kaltër të mbyllur me stemën e Republikës në mes.
Për fëmijët nën moshën 3-vjeçare, afati i pasaportës do të jetë tri vjet, për qytetarët e moshës pesë deri në 27-vjeç, afati do të jetë pesë vjet, ndërkaq pasaporta me vlefshmëri 10-vjeçare do të lëshohet për personat më të vjetër se 27 vjet.

Një pjesë e shqiptarëve i kanë refuzuar pasaportat jugosllave, thjesht nga ndjenja e patriotizmit, ndërsa shpresa dhe ëndrra për të pasur një pasaportë të shtetit të tyre, që për një kohë të gjatë ishte element që i pengonte shqiptarët të pajisen me pasaportë të huaj, vinte duke u zbehur pasi që nevojat vitale bënin që të mbylleshin sytë përballë përkatësisë së pasaportës.

Pas një kohe administrata e UNMIK-ut filloi të lëshojë dokumente të udhëtimit për të gjithë qytetarët e Kosovës. Çdo individ që ishte regjistruar si qytetar i Kosovës dhe posedonte letërnjoftim, kishte të drejtën e aplikimit për dokumentit e udhëtimit. Mirëpo edhe ky dokument nuk i plotësonte nevojat e plota të qytetarëve, pasi nuk njihej nga të gjitha vendet.

Numri i shteteve që e kishin pranuar zyrtarisht dokumentin e udhëtimit të lëshuar nga UNMIK-u arrinte në 39, por kishte edhe disa vende të tjera të botës, të cilat zyrtarisht nuk e kishin deklaruar njohjen e këtij dokumenti, por poseduesve të dokumentit iu lejohej hyrja nëpër ato vende.

Pasi pasaporta jugosllave ende lëshohej në Kosovë, shumë prej qytetarëve pajiseshin me këtë dokument, e nuk ishin të rralla rastet kur qytetarët posedonin të dy dokumentet e udhëtimit. Kjo bëhej për shkak se pasaporta jugosllave, për dallim me dokumentit e udhëtimit të UNMIK-ut, njihej nga shumë vende të botës. ■

Domosdoshmëria e

Universiteti i Prishtinës (UP) duhet të shkoj përpara drejt rrugës së evrop kjo do të kontribuojë në cilësinë e edukimit. Universiteti, si institucion, dh tarizimi i vazhdueshëm.



Gëzim QERIMI

Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e edukimit është primar për një institucion, objektiv i të cilit është mbajtja e edukimit në nivelin ndërkombëtar.

Komuniteti përfiton nga ndërkombëtarizimi i Universitetit, pasi në këtë mënyrë gjenerohen kooperime dhe kontakte, të cilat janë të rëndësishme për interesat e tij kulturore ekonomike dhe politike.

Universiteti i Prishtinës i ka dhënë prioritet të lartë bashkëpunimit ndërkombëtar, duke u fokusuar në participimin intensiv në Kartat e programeve -Tempus, Erasmus Mundus, Erasmus (external window), Socrates, Leonardo da Vinçi, iniciativave regjionale të Evropës Juglindore, kooperimit me shtetet fqinje dhe më gjerë.

Duke mbështetur principet e Bolonjës të njohjes së gradave dhe studimeve, promovimit të Suplementit të Diplomës, implementimit të ECTS-së, zhvillimit të politikave dhe sistemit të sigurimit të cilësisë, cilësisë së vlerësimit në edukimin e lartë, zhvillimit të strategjisë universitare për edukim të vazhdueshëm, UP participon në projekte evropiane në zhvillim dhe harmonizim të kurrikulumeve, mobilitet të studentëve dhe stafit akademik, kooperime multilaterale dhe bilaterale në fusha të ndryshme brenda programit Tempus.

Task forca - pjesë e ndërkombëtarizimit të UP-së

Edukimi ndërkombëtar i studentëve dhe i stafit akademik të UP, promovimi i hulumtimit dhe inicimi i politikave publike konform qendrave ndërkombëtare, reputacioni i UP përmes partneriteteve të reja dhe unike, etj, janë pjesë e "task forcës" që shndërron UP-në në pjesë të ndërkombëtarizimit.

Disa nga aktivitetet për të arritur task forcat janë: mobiliteti i stafit akademik, integrimi me përvoja akademike dhe ndërkombëtare, integrimi i programeve ndërkombëtare në kurrikulumet akademike, domosdoshmëria e themelimit të qendrës



e ndërkombëtarizimit të UP-së

ianizimit dhe ndërkombëtarizimit, pasi e komuniteti përfitojnë nga ndërkombë-

për hulumtim shkencor, mobiliteti i studentëve dhe studimet jashtë vendit.

Studentët dhe stafi akademik për shkëmbim ndërkombëtar mbështetet nga grante UE (Erasmus), grante të tjera ndërkombëtare si dhe shkëmbime kulturore ndërkombëtare.

Theks i veçantë i jepet bashkëpunimit me universitetet e regjionit.

Programi për mësimin tërëjetësor i siguron shans për trajnime praktike në Evropë dhe më gjerë, stafit akademik dhe studentor përmes skemave Fulbright, Këshillit Amerikan, Leonardo da Vinci, Socrates etj.

UP organizon UVP, përmes së cilit sjellin studentë nga gjithë bota. Ky program u mundëson studentëve ndërkombëtarë të integrohen me studentë të UP, duke u përfshirë në kurse të përzgjedhura që fokusohen në dimensionin social dhe kulturor.



UP ka rreth 85 marrëveshje të bashkëpunimit me universitetet evropiane dhe amerikane.

Mobiliteti i studentëve gjatë vitit 2007:
13 Bursa (studime dhe kurse), Gjermani (DAAD),
5 Bursa për doktorë shkence (PhD), Holandë (SPARK),
2 Bursa studime një vjeçare, BA Norvegji, Hedmark University,
2 Bursa specializime tre muaj, Austri (ADA),
1 Burse studime një vjeçare, Gjermani Jena University,
2 Bursa PhD, Zyra kulturore Franceze,
2 Bursa për PhD, për asistentë të Fakultetit të Xehetarisë, Universiteti Clausthal (UP),
20 Bursa për PhD, për asistentë të fakulteteve të ndryshme, Universitete Austriake,
8 Bursa për PhD, për Fakultetin e Mjekësisë, Universitete Austriake,
1 Bursë MA Francë

Bashkëpunimi bilateral i UP-së me universitetet tjera

Objektiv i UP-së është që të promovojë kontaktet bilaterale me universitetet e tjera, duke u bazuar në marrëveshjet e nënshkruara të bashkëpunimit (format i përgjithshëm); shkëmbimi i stafit akademik dhe i studentëve, i stafit administrativ dhe profesional; organizimi i kurseve të përbashkëta; vizita studimore; konferenca dhe seminare; participim në konferenca shkencore, simpoziume dhe seminare; projekte të përbashkëta shkencore; shkëmbime të përvojave të përpilimit të syllabuseve, metodologjive të mësimdhënies dhe teknologjive të përdorura në procesin didaktik; shkëmbimi i publikimeve shkencore si dhe forma të tjera të kooperimit me interes të përbashkët.

Universiteti i Prishtinës për vitin akademik 2008-2009 duhet të angazhohet në intensifikimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe të shtohet implementimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit ndëruniversitar.

Është e nevojshme, gjithashtu, që të realizohet partneriteti i UP-së me universitetet e tjera në koordinim të projektit Erasmus - Mundus/ECW, me qëllim të implementimit të mobilitetit për tri ciklet studimore, postdoktorate

dhe të stafit akademik; të absorbohen fondet e Komisionit Evropian-programi Tempus, në mënyrë sa më efektive dhe në dobi të Universitetit të Prishtinës për ta reformuar atë në përputhje me Procesin e Bolonjës; të bëhen përpjekje për involvim të UP-së në projektet për mësim të programit (LLL-Socrates- Erasmus, Erasmus Mundus, Leonardo da Vinci); përfshirja e UP në projekte shkencore ndërkombëtare si FP7; përfshirja e UP-së në seminaret për Promovim të Bolonjës; bashkëpunimi më i ngushtë me Organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, me qëllim të thithjes sa më të mirë dhe të koordinuar të fondeve për zhvillimin e UP-së si: ËUS-Austria, DAAD, USAID, World Learning, ESCE, SPARK, ADA, ABA Roli, ASO, Banka Botërore, American Councils, British Councils, si dhe me Zyrat ndërlidhëse e ambasadat.

Gjithashtu është e nevojshme që të realizohet pjesëmarrja e UP-së në takime të rregullta të Asociacioneve Universitare Evropiane, Rrjetave universitare si dhe Organizatave të ndryshme me rëndësi; në seminare dhe takime vjetore për të shkëmbyer përvojat universitare me qëllim të reformimit të UP-së.

Shpresë e UP është që trupi i ri studentor të zhvillojë objektivat e tij afatgjate, jo vetëm për shkak të frymës organizative, por për shkak të përpjekjes njerëzore.

Karakteristikë e studentëve të UP mbetet pavarësia, kreativiteti, vetëbesimi dhe aftësia të rrezikojnë në drejtim të përpjekjeve të reja.

Me rëndësi është që të vlerësohen të diplomuarit e UP jo vetëm me atë se çka dinë, por me atë se çka bëjnë me atë që dinë. ■

Fenomeni i braktisjes së shkollës dhe delikuenca



Fitim VELIU

Kohët e fundit po debatohet shumë për dy probleme të aktualitetit të shoqërisë së Kosovës. Problemi i parë është fenomeni i braktisjes së shkollës nga të rinjtë. Rreziku që sjell braktisja e shkollës po prodhon, në fakt, fenomenin tjetër, atë të delikuencës.

Këto dy fenomene paraqesin rrezikshmërinë e tyre në dy drejtime: e para, braktisja e shkollës e shton analfabetizmin, edhe ashtu të madh në Kosovë dhe po ashtu hap rrugën drejt asimilimit. Të rinjtë që braktisin shkollën mësyjnë rrugët negative që prodhojnë fenomenin e kriminalitetit, gjë që çon në asimilimin e llojit fizik jo vetëm të individit, por edhe të shoqërisë në përgjithësi. Kjo dukuri e rrezikshme është evidente dhe ky shqetësim është shprehur edhe nga mediat e OJQ-të e ndryshme nëpërmjet debateve. Mendimi i përbashkët është se ka braktisje, ka delikuencë, por mungojnë mekanizmat për parandalimin e këtyre dy fenomeneve.

Këto dy dukuri janë bërë barrë e pakalueshme dhe një enigmë e madhe për gjithë shoqërinë tonë në përgjithësi. Ministri i Arsimit, Enver Hoxha, në një emision televiziv, ka pranuar se ka braktisje të shkollës nga një numër i madh nxënësish. Ai kishte qenë prezent edhe vetë në Gjakovë, kur një fëmijë e kishte braktisur shkollën për të punuar që të mbante familjen e tij. Familja e këtij nxënësi mori përkrahjen e ministrit që djaloshi të vazhdonte shkollimin e tij, por ky është vetëm një rast, ndërsa shumë raste të tjera, sidomos në zonat rurale, kalojnë pa u vërejtur.

Pse po braktiset shkolla?

Janë dy faktorë shumë evidentë që ndikojnë në braktisjen e shkollës: E para, iniciativa për braktisjen e shkollës vjen nga familja, sepse mungesa e kushteve elementare për jetesë bën që këta fëmijë të dalin nga shkolla në rrugë, për të mbajtur familjen. Një pjesë e këtyre fëmijëve bëhen cigareshitës, disa mbledhin hekurishte të vjetra, por ka edhe mjaft raste kur këta të rinj merren me shpërndarjen e drogës dhe punë të tjera kriminale. Faktori i dytë që shpie deri të braktisja është cilësia e dobët e mësimdhënies. Sot në shkollat tona, jo vetëm fillore, por edhe ato të mesme, mbizotëron kuadri tradicional i cili aplikon formën e ligjërimit pozitivist, ku gjithmonë marrja e informacionit bëhet mbi bazën e shkollës së vjetër të formimit të tyre, që lidhet me sistemet që i takojnë së kaluarës. Derisa dija ka evoluar, kuadri është po ai vjetri. Ideja që ky kuadër të ndjekë seminare është metodë shterpe, sepse ata ligjërojnë në bazë të sistemit të vjetër. Ajo që është përdorur për 40 vite, është e pamundur të ndryshohet për 40 ditë.

Edhe sot, mësuesi dhe profesori janë autoritarë në dhënien e informacionit, gjë që e pengon komunikimin si bashkëpjesëmarrje vendimesh ndërmjet profesorit dhe nxënësit. Andaj, lënia anash e nxënësve në procesin e komunikimit e humb interesimin e nxënësve në mësim, gjë që ndikon në humbjen e invencionit për të vazhduar shkollën, sepse nxënësit nuk arrijnë të marrin materien e lëndës...

Është koha e fundit që të shmanget ligjërimi me metodën e sistemeve tradicionale, sepse kërkesa e shijes ka ndryshuar. Duhen përvetësuar metodat e reja, e kjo bëhet nga studiuesit e rinj.

Andaj, duhet t'u kushtohet kujdes shumë i madh këtyre dy faktorëve jetikë, përndryshe avazi i vjetër i braktisjes nuk do të ndalet. ■



Në prag të Konferencës së Donatorëve për Kosovën

Rast i mirë për shtetin e ri

Republika e Kosovës pritet të përfitojë mbi një miliardë euro në këtë Konferencë, prandaj kjo konferencë konsiderohet si një ndihmesë e madhe dhe rast i mirë për vendin tonë, në rrugën drejt rimëkëmbjes dhe zhvillimit ekonomik si dhe krijimit të një bazamenti të fortë për të ardhmen.



Sead UJKANI

Në muajin qershor pritet të mbahet Konferenca e Donatorëve për shtetin e Kosovës, në të cilën pritet të marrin pjesë një numër i madh vendesh të zhvilluara, të cilat kanë treguar gatishmërinë për përkrahjen e Kosovës në rrugën e saj të rritjes ekonomike, shtimit të punësimit dhe veçanërisht për ndihmesën në drejtim të shlyerjes se borxhit të jashtëm që ka Kosova.

Rëndësia e organizimit të një Konference të tillë është mjaft e madhe duke marrë parasysh nevojat e mëdha për mjete financiare që ka Kosova në njërën anë, si dhe mundësitë e kufizuara buxhetore për investime në anën tjetër.

Sekretari i përgjithshëm i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Ejup Qerimi në një prononcim për revistën "Paqja", e ka vlerësuar si shumë të rëndësishme këtë Konferencë. Duke folur rreth organizimit të kësaj Konference, si dhe rëndësisë që ka ajo për Republikën e Kosovës, Qerimi ka theksuar: "Duke marrë parasysh se është fjala për krijimin e shtetit të ri dhe nevojave që ka momentalisht Kosova, organizimi i Konferencës së Donatorëve është i një rëndësie të pakontestueshme. Pra, kjo është një mënyrë standarde e komunikimit në mes të donatorëve të interesuar për ndihmë dhe palës që ka nevojë, në këtë rast, Republika e Kosovës".

Sekretari i OEK-ut ka potencuar edhe rëndësinë që ka stabilizimi politik dhe zhvillimi ekonomik i Kosovës për mbarë regjionin në përgjithësi. "Kjo lidhet edhe me rëndësinë e stabilizimit politik të rajonit, sepse krijimi i një shteti të qëndrueshëm politikisht dhe ekonomikisht është edhe në dobi të vendeve të tjera në regjion dhe disa prej vendeve kryesore donatore në këtë konferencë, siç është Bashkimi Evropian, Banka Botërore dhe institucionet e tjera financiare. Kjo lidhet, gjithashtu, edhe me agjendën politike të vendeve që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, të cilët, përpos njohjes formale, dëshirojnë të ndihmojnë që ky shtet të stabilizohet dhe zhvillohet ekonomikisht" – ka theksuar Qerimi.

Projektet janë fokusuar në sektorët e energjetikës, infrastrukturës, bujqësisë, shëndetësisë dhe arsimit

Mbajtja e Konferencës së Donatorëve për Kosovën shikohet, gjithashtu, si një mundësi e mirë në aspektin e tërheqjes së donacioneve në fushat primare që ka nevojë Kosova, duke potencuar këtu faktin që projektet e prezantuara të jenë të një rëndësie nacionale. Prandaj, në këtë drejtim, përkrahja e donatorëve do të varet edhe nga projektet të cilat do të prezantohen në këtë konferencë.

Në Konferencën e Donatorëve të gjitha komunat dhe ministritë do të paraqiten më projektet e tyre në fushat përkatëse, të cilat janë harmonizuar në pajtim të plotë më lëmit prioritare të identifikuara nga Qeveria e vendit. Kontrollin dhe harmonizimin e këtyre projekteve e ka bërë nja grup punues i caktuar enkas për këtë gjë nga ana e Qeverisë.

Janë identifikuar pesë fusha prioritare të cilat gëzojnë rëndësinë më të madhe për investime nga ana e Qeverisë së vendit tonë.

"Projektet me prioritet që janë përpiluar dhe do të prezantohen në Konferencën e Donatorëve, me qëllim të rritjes ekonomike dhe përmirësimit të standardit jetësor, janë fokusuar në sektorët e energjetikës, infrastrukturës, bujqësisë, shëndetësisë dhe arsimit" – ka thënë zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi.

Ndërsa, për sekretarin e OEK-ut, Ejup Qerimin, investimet në infrastrukturë kanë rëndësinë më të madhe, "sepse infrastruktura paraqet bazën për zhvillim ekonomik". Sipas Qerimit, projektet të cilat, me siguri, do gjejnë përkrahje janë edhe projektet që lidhen me arsimin dhe të një rëndësie të veçantë do jenë edhe projektet për zhvillimin e sektorit privat.

Republika e Kosovës pritet të përfitojë mbi një miliardë euro në këtë Konferencë, prandaj kjo konferencë konsiderohet si një ndihmesë e madhe dhe si një rast i mirë për vendin tonë në rrugën e tij drejt rimëkëmbjes dhe zhvillimit ekonomik si dhe krijimit të një bazamenti të fortë për të ardhmen. ■

Një rëndësi e veçantë në këtë Konferencë do t'u kushtohet projekteve që kanë të bëjnë me sektorin e energjetikës, duke ditur gjendjen kritike në të cilën ndodhet ky sektor. Në publikimin e fundit të bërë nga UNDP-ja vlerësohet se sistemet ekzistuese të prodhimit dhe të furnizimit me energji elektrike kanë pësuar shumë nga mungesa shumëvjeçare e investimeve dhe ato nuk mund të përmbushin kërkesat e tanishme, ose ato që priten në të ardhmen. Mungesa e një furnizimi të qëndrueshëm dhe adekuat me energji elektrike kufizon zhvillimin e biznesit dhe potencialin për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

"Big Brother" dhe shqiptarët

Shqipëria është vendi i katërt në Ballkan që i ka ofruar popullit të saj mundësinë e një "show reality - Big Brother" sikurse edhe vendet fqinje në Ballkan, por edhe më gjerë.

Emine A. VEZAJ

'Show' më i ndjekur në gjithë botën, "Big Brother" është zhvilluar për herë të parë në Holandë, para shtatë vitesh, nga kompania "Endemol". Sivjet "Big Brother-i" është "importuar" edhe në Shqipëri, nëpërmjet televizionit "Top Chanel" (TCH) në bashkëpunim me kompaninë "Endemol".

Ky 'show' ka shtrirje tashmë në disa kontinente. Në Afrikë e organizon: Angola, Gana, Kenia, Nigeria, Tanzania, Uganda, Zambia, Zimbave, etj, në Lindjen e Mesme e organizon: Bahrejni, Egjipti, Iraku, Jordani, Kuvajti, Libani, Omani, Arabia Saudite, Somalia, Siria dhe Tunizi, në Evropë: Norvegjia, Suedia, Sllovenia, Bosnje Hercegovina, Mali i Zi, Serbia dhe Shqipëria.

'Big Brother' është një format televiziv tejet i veçantë. Brenda një shtëpie futen 14 konkurrentë që nuk njohin njëri tjetrin dhe që do të jetojnë aty brenda tre muajsh të izoluar nga bota e jashtme dhe nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të kamerave televizive. Çdo javë nga shtëpia e "Big Brother"-it do të eliminohet një konkurrent. Konkurrentët e "Big Brother"-it janë të izoluar dhe nuk mund të lexojnë shtypin, të shohin televizor, të kenë qasje në internet, apo të shkruajnë letra. Në këtë garë, ai që fiton simpatinë e teleshikuesve është edhe fitues i çmimit të madh prej 50.000 eurosh.



Por çfarë kultivon e gjithë kjo te shikuesi: paranë, famën personale, degjenerimin, rritjen e shikueshmërisë së emisioneve televizive apo edhe pasqyron zhvillimin ekonomik të një vendi?

Paraja

Paraja është bërë ndër prioritetet më parësore në jetë. Për pará njeriu sakrifikon besimin, jetën, moralin, dinjitetin e tij dhe çdo gjë tjetër të shenjtë. Edhe ky program televiziv, i paraqitur si me karakter modern, nxjerr në pah atë që paraja pasqyron realisht në jetën e njeriut. Në ekranet televizive çdo njëri prej nesh mund të shohë realitetin e hidhur të dominimit të parasë karshi moralit, shoqërisë dhe asaj që quhet njerëzore. Nuk është aspak spekulim të thuhet, se paraqitja e disa skenave paturpësie nga kandidatët që gjenden të izoluar brenda mureve të asaj shtëpie, janë pasqyrim i asaj që të shtyn të bësh paraja. Në shumicën e rasteve është paraja ajo që e shtyn individin që karshi interesit personal të njollosë besimin e tij, të injorojë shoqërinë, të zhvlerësojë moralin e dikujt si dhe të bëjë skena nga më të paturpshmet, vetëm e vetëm për një premtim që nuk është fiks për asnjërin në atë shtëpi.

Shkëlqimi, që është personi i sapodalë nga shtëpia e 'Big Brother'-it në pyetjen e TCH, se: a ka qenë paraja ndër gjërat më të rëndësishme aty në B-B, tha: Unë kuptova se kur bëhej fjalë për para, doli shprehja "unë jam pa sedër", që do të thotë, mund të bësh çdo gjë për të fituar.

Fama personale

Më kujtohet një "poete", mysafire e ftuar në emisionin



e Arian Çanit, “Zonë e lirë”. Emrin e saj nuk e mbaj mend, por nuk e kam harruar mendimin e saj skandaloz se çfarë do të bënte ajo vetëm e vetëm të bëhej e famshme. Pyetjes së Çanit se: a do të ushtroje edhe prostitucionin dhe të gjitha rrugët e shëmtuara që një ditë të bëhej e famshme, “poetja” pa hamendësimin më të vogël iu përgjigj në mënyrë pohuese, duke theksuar se fama për të do të thotë çdo gjë...

Nuk më habisin aspak edhe skenat e tanishme të këtij emisioni të transmetuar nga Top Chanel, ngase pjesëmarrësit në këtë garë, shfrytëzojnë të gjitha mundësitë vetëm e vetëm për t'u bërë të famshëm. Madje, vetë paraqitja e disa prej tyre, që janë të martuar dhe kanë familjen në shtëpi, është një rast i mirë të kuptohet se çfarë do të thotë të sakrifikosh veten dhe familjen për të ashtuquajturën FAMË. Andaj, nëse dikur ka qenë puna ajo që ka mundur ta bëjë të famshëm dikë, sot këtë mund ta bëjnë me lehtësi horrllëqet dhe mediat që i pasqyrojnë në mënyrë publike këto pamje.



Degjenerimi

Të mësosh dikë për punë të mira është vështirë, të degjenerosh dikë sot është shumë lehtë. Nga paraqitja e kandidatëve në ekranet televizive shikuesi mund të vlerësojë pamjen degjeneruese tek secili nga kandidatët. Veshja e tyre, fjalori i përdorur, dhuna, ofendimet e pakursyera në mes tyre, paraqitja e fotografive në ‘site’ të ndryshe në internet, ankandi i hapur për fotografitë e tyre, janë edhe një mundësi shtesë që të rinjtë të formojnë identitetin e tyre sipas modelit të asaj që ata shohin tek ata që paraqiten njëzet e katër orë në ekranet televizive të secilit prej nesh. Çfarë presim nga kjo? Degjenerimin dhe sfidën që duhet të përballojë populli shqiptar.

Zhvillimi ekonomik...

Nëse pasqyrimi i zhvillimit ekonomik të një vendi ka mbetur që të paraqitet përmes këtyre emisioneve, mjerë shteti nga kush pasqyrohet. Nikola Nikolov në librin e tij “Komploti Botëror” sjellë një shembull, se cili mund të konsiderohet një shtet i kompletuar: “Një shtet mund të lëvdohet me rrugët e tij të mira; tjetri me ligjet e tij të mira, i treti mund të krenohet me njerëzit e mirë, një shtet i mirë i ka të tria”. Hmm.., çudi, si nuk përmendet asnjëherë që zhvillimin e një shteti e pasqyrojnë degjenerimet televizive që paraqesin mediat tona?!

“Kosovarja” në “Big Brother”

Vajza nga Gjilani është viktima e parë e identitetit “kosovar”. Ajo nuk është aspak e ngjashme me koleget e saj shqiptare, në këtë shtëpi të mbyllur tash e sa kohë. Diversiteti që përshkon “kosovaren” e shkretë në atë shtëpizë fillon që nga diversiteti mendor, gjuhësor e kulturor. Pse gjilanasja është ashtu si është? E mbyllur në një mentalitet ‘alla’ kosovare. Ajo e ka shumë të vështirë të flasë e të veprojë sikurse familjarët e tjerë brenda shtëpisë. Sjelljet e saj të kushtëzuara para publikut dhe “Vëllait të madh - Big Brother”-it, vazhdojnë ta mbajnë të mbyllur edhe më pjesën tjetër të identiteti kosovar. Vajza nga Kosova, me përjashtim të fallit që e qet për merak, ende nuk ka mundur të sjellë ndonjë njohuri të asaj që ka mësuar në shkollë apo në studimet që thotë se i vazhdon. Përveç muzikës dhe gjuhës angleze që di, ajo nuk ka aspak njohuri për botën e shkencës dhe teknologjisë bashkëkohore.

Morali në krizë

Duhet thënë se morali është në krizë. Për këtë dikush do të fajësonte politikanët, dikush do të fajësonte mësuesin, dikush do të fajësonte babain si përgjegjës të familjes, të tjerët nënën, pasi ajo është edukatorja e parë. Si duket, asnjëri nga këta nuk e pranon fajin, se jo vetëm që faji tani është jetim, por, në këtë rast, të gjithë janë fajtorë, duke filluar nga familja, shoqëria, madje edhe të gjithë ata që e përkrahin këtë realitet. Në këtë rast, faji nuk është jetim, por të gjithë jemi pjesëmarrës, pasi ne jemi ata që bëhemi tifozë të tyre duke kontribuar me votat tona se cilët nuk duhet të mbesin, e cilët duhet të vazhdojnë garën.

Të gjitha këto emisione ne do të mund t'i parandalonim me një JO të fuqishme, por ne nuk e bëjmë këtë sepse fuqia jonë nuk është dorë e forcës, por fjalë e gojës. ■



Reflektime ndërkombëtare për Kosovën

Bie interesimi për Kosovën...

Demir RESHITI

Gjatë muajit prill vetëm tri shtete (Ishujt Mareshall, Nauru dhe Burkina Faso) e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Për dallim nga muajt e kaluar kur Kosova ka qenë në qendër të vëmendjes së institucioneve ndërkombëtare, këtë muaj duket se ka rënë interesimi për Kosovën. Ngecjen e njohjes së shtetit të Kosovës, Beogradi zyrtar ia ka faturuar angazhimit të diplomacisë ruse dhe asaj serbe. Madje shefi i diplomacisë ruse Sergei Lavrov, në një intervistë për agjencinë ruse të lajmeve TASS ka pranuar se Rusia i ka përdorur të gjitha mundësitë për të çrregulluar planet për njohjen e shpejtë dhe të gjerë të Kosovës.

Për gjendjen në Kosovë është diskutuar në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, në Nju Jork dhe me atë rast janë vlerësuar të arriturat në tre muajt e fundit. Në këtë takim, janë vërejtur sërish mospajtime të thella mes vetë anëtarëve të Këshillit...

Në vazhdim po paraqesim një kronologji të ngjarjeve dhe deklaratave më të rëndësishme lidhur me Kosovën, gjatë muajit prill 2008.

(1 prill) Casey: Armë për Kosovën për të forcuar institucionet

Uashington-Zëdhënësi i Departamentit amerikan të Shtetit, Tom Casey ka thënë se ka qenë politikë e qeverisë së Shteteve të Bashkuara njohja e pavarësisë së Kosovës, dhe ka ritheksuar se edhe ndihma dhe furnizimi me armatim është pjesë e planit për aftësimin e forcave të saj që të funksionojnë të pavarura.

(2 prill) Lavrov: Rusia nuk do të lejojë anëtarësimin e Kosovës në OKB

Moskë – "Kemi bërë gjithçka që patëm mundësi për të çrregulluar planet për njohjen e shpejtë dhe të gjerë të Kosovës", ka thënë shefi i diplomacisë ruse Sergei Lavrov, në një intervistë për agjencinë ruse të lajmeve TASS. Lavrov citohet të ketë thënë se "Rusia nuk mund të lejojë anëtarësimin e plotë të Kosovës në OKB".

(7 prill) Al Saud: Do ta njohim Kosovën

Riad – Arabia Saudite është gati për të njohur shtetin e Kosovës. Këtë gjë e ka konfirmuar vetë mbreti i Arabisë, Abdullah bin Abdul Aziz Al-Saud në takimin me kryetaren e Kuvendit të Shqipërisë, Jozefina Topalli. Mbreti saudit ka shprehur mbështetjen për kauzën e shqiptarëve dhe urimet më të mira për shtetin më të ri në Evropë.


Abdullah Al-Saud

(8 prill) SHBA-të hapin Ambasadën e tyre në Kosovë

Prishtinë - Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë hapur ambasadën e tyre Kosovë. Në një ceremoni që është zhvilluar në Prishtinë, shefja e Zyrës Amerikane, Tina Kaidanov, ka përsëritur edhe një herë mbështetjen e shtetit të saj për Kosovën.

(10 prill) Ban Ki-Moon: "Pavarësia e Kosovës është e pakthyeshme"

Moskë - Kreu i OKB-së, Ban Ki Moon, ka deklaruar gjatë vizitës së tij në Rusi, se procesi i pavarësisë së Kosovës është i pakthyeshëm. "Është e pamundur të kthehet status-quo- ja", ka thënë Ban Ki Moon në një konferencë për shtyp, duke shtuar se ai kishte ardhur në Rusi për mbështetje e "jo për kritikë".


Ban Ki Moon

(11 prill) McCormack: Nuk i takon Serbisë të bëj zgjedhje në Kosovë

Uashington – "Ia vlen t'ua kujtojmë të gjithëve se Kosova është një shtet sovran dhe nuk i takon një shteti tjetër sovran që të bëjë thirrje dhe të organizojë zgjedhje në një tjetër shtet sovran", ka thënë zëdhënësi i Departamentit Amerikan të Shtetit, Sean McCormack në një takim me gazetarë.

(11 prill) Craddock: Pak vende e kanë njohur Kosovën

Uashington - Komandanti i lartë i NATO-s për Evropën, Bantz Cradock ka shfaqur shqetësimin e tij për shkak se shumë pak vende anëtare të NATO-s e kanë pranuar pavarësinë e Kosovës. "Vetëm 34 vende e kanë njohur Kosovën, kjo është pak shqetësuese" – ka thënë Cradock gjatë një paraqitje në Dhomën e Përfaqësuesve të Kongresit Amerikan.


Bantz Craddock

(14 prill) Judah: Serbia po luan një lojë të dyfishtë me UNMIK-un

Pragë - Serbia po luan një lojë të dyfishtë me UNMIK-un. Në një anë Beogradi kërkon të respektohet kjo rezolutë, ndërsa në anë tjetër e shkel atë me të dyja këmbët, duke marrë vendim për zgjedhje në Kosovë – ka deklaruar analisti Tim Judah, duke tërhequr vëre-

jtjen se Rezoluta 1244 po shfrytëzohet nga të gjitha palët, duke e interpretuar në mënyrën që u pëlqen.


Dimitrij Rupel

(15 prill) Rupel: Interesim i madh i Shtëpisë së Bardhë për Kosovën

Uashington - "Shtëpia e Bardhë mendon se Sllovenia duhet të bëj në një farë mënyre më shumë trysni tek ata që marrin vendime rreth Kosovës dhe Serbisë dhe, në përgjithësi, rreth Ballkanit Perëndimor" – ka deklaruar shefi i diplomacisë sllovene, Dimitrij Rupel, pas një takimi në Shtëpinë Bardhë me këshilltarin për Siguri Kombëtare, Stephen Hadley, ku temë bosht e diskutimeve ka qenë Kosova.

(16 prill) Bush dhe Ban Ki-Moon bisedojnë për Kosovën

Presidenti amerikan, George Bush dhe sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Ban Ki-Moon, kanë biseduar ne telefon për çështje aktuale botërore dhe, në këtë kuadër, edhe për situatën në Kosovë. Zëdhënësi i Shtëpisë së Bardhë, Gordon Johndroe, ka thënë se presidenti Bush dhe sekretari Ban Ki-Moon, diskutuan për bashkëpunimin ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, "për t'u siguruar se Kosova është vend stabil".

(17 prill) Republika e Ishujve Marshall, njohu Republikën e Kosovës

Delap-Uliga-Darriti -Ministri i Punëve të Jashtme i Republikës së Ishujve Marshall, Tony A. deBrum i ka dërguar kryeministrit të Qeverisës së Kosovës, z. Hashim Thaçit, letrën zyrtare për njohjen e Republikës së Kosovës, shtet i pavarur dhe sovran. Në letër, në mes të tjerash, thuhet:

"Në emër të Shkëlqesisë së Tij, presidentit Litokëa Tomeing, ju njoftoj se Qeveria e Republikës së Ishujve Marshall njeh Republikën e Kosovës, shtet të pavarur dhe sovran. Republika e Ishujve Marshall është anëtare e OKB-së.

(18 prill) OKB: As nuk i ndihmojmë e as nuk i pengojmë zgjedhjet

Nju Jork – "Zgjedhjet parlamentare serbe të 11 majit, UNMIK-u as nuk do t'i ndihmojë e as t'i pengojë, siç edhe ka vepruar në të kaluarën" – ka deklaruar zëdhënësja e OKB-së, Michele Montas. "Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm vetëm mund të autorizojë organizimin e zgjedhjeve për ato institucione që parashihen me rezolutën 1244. Pra, rezoluta 1244 për ne mbetet udhërrëfyese" – ka thënë Montas.


OKB

(22 prill) Këshilli i Sigurimit me pikëpamje të ndryshme për Kosovën

Nju Jork - Takim i parë i KS-së të OKB-së, që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, në të cilin janë vlerësuar të arriturat në tre muajt e fundit, sërish ka kaluar me mospajtime të thella mes vetë anëtarëve të tij.

Grupi i vendeve që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, i prirë nga SHBA dhe Britania e Madhe, ka vlerësuar arritjet në javët e para të krijimit të shtetit të ri, por ka bërë thirrje për ruajtjen e qetësisë dhe të stabilitetit.

(23 prill) - Republika e Naurusë ka njohur Republikën e Kosovës

Nju Jork - Misioni i Përhershëm i Republikës së Naurusë në OKB e ka njoftuar Presidentin e Republikës së Kosovës, Fatmir Sejdiun, se ky vend, që shtrihet në perëndim të Oqeanit Paqësor dhe është anëtar i OKB-së, ka vendosur ta njohë Republikën e Kosovës - si shtet të pavarur dhe sovran dhe ka njoftuar se Qeveria e Naurusë pranon propozimin për vendosjen e marrëdhënieve të plota diplomatike dhe misionit diplomatik, në bazë të Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike.

(24 prill) Burkina Faso ka njohur zyrtarisht shtetin e Kosovës

Ugadugu-Burkina Faso ka njohur zyrtarisht shtetin e Kosovës. Në komunikatën e qeverisë në kryeqytetin Ugadugu, thuhet se "Burkina Faso pranon ekzistimin e një shteti të ri dhe sovran, në pajtim me të drejtën ndërkombëtare". Ky vend, po ashtu është shprehur i gatshëm për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Kosovën.

(25 prill) – "The Guardian": Muajt e ardhshëm mund të ketë tensioneve ndëretnike në Kosovë

Londër - Komandantët e NATO-s presin që në muajt në vijim të ketë rritje të tensioneve ndëretnike në Kosovë, qoftë për shkak të mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare dhe lokale serbe, qoftë për shkak të Kushtetutës, e cila më 15 qershor do të vërtetojë pavarësinë e Kosovës, gjë që serbët nuk e pranojnë. "Gjendja në Kosovës është gjithnjë e paparashikueshme", citon gazeta londineze "The Guardian" një gjeneral britanik të angazhuar pranë misionit të OKB-së në Kosovë.



The Guardian

(26 prill)- Rupel: Bashkësia ndërkombëtare të jetë e gatshme në Kosovë

Lubjanë - Shefi i diplomacisë sllovene Dimitrij Rupel ka thënë se bashkësia ndërkombëtare duhet të jetë e përgatitur për zhvillimin e ngjarjeve, pasi të hyjë në fuqi Kushtetuta e Kosovës... Rupel ka theksuar se BE-ja angazhohet për karakter evropian të pranisë ndërkombëtare në Kosovë, pasi, në rend të parë, kjo është çështje evropiane. ■



Fotoreportazh nga punimet në përmirësimin e infrastrukturës rrugore në Kosov

Atmosferë pune në rrugët e K

Ndërtimit të infrastrukturës rrugore në Kosovë duket se po i jepet rëndësi e veçantë nga ana e qeverisë. Në bazë të informacioneve nga Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit të Kosovës, janë duke u ndërtuar dhe pritet të asfaltohen disa segmente të rrugëve rajonale dhe lokale, si edhe është duke u bërë zgjerimi i magjistrales M9 në segmentin rrugor Prishtinë – Fushë Kosovë, po ashtu edhe zgjerimi i magjistrales M2 në segmentin Çagllavicë – QMI.

Për t'u njohur më për së afërmi me punët që po zhvillohen, vizituam disa nga vendpunimet nëpër rrugët që po zgjerohen dhe riasfaltohen në Prishtinë dhe jashtë saj.



Qytetarët e Prishtinës janë dëshmitarë të faktit se shumica e rrugëve kryesore të kryeqytetit janë duke u rinovuar. Në fillim janë vendosur pusetat e ujëmbledhësve të kanalizimeve të ujërave atmosferikë në një nivel më të lartë, pastaj është bërë gërryerja e asfaltit ekzistues dhe pritet që të vendoset një shtresë e re asfalti në këto rrugë.



Pamje nga punimet për zgjerimin dhe riasfaltimin e magjistrales M9 në segmentin rrugor Prishtinë – Fushë Kosovë, ku punimet kanë filluar me 19 prill dhe pritet të përfundojnë më 1 korrik 2008.





Punët e ndërtimit të kësaj rruge i kryen SH.P.K. "KAG Asphalt CO." nga Prizreni. Sipas pronarit të kësaj kompanie Ramadan Gashi, punët janë duke u kryer me një dinamikë të shtuar, ku punohet 24 orë.



Përpos heqjes së materialit të butë, i cili mihet me një thellësi më të madhe se 50cm në të dyja anët e rrugës, bëhet shtrimi i një pëlhure të ndërtuar me fije sintetike e cila ka për qëllim që të bëjë stabilizimin e gurit të thyer që shtrohet në ato pjesë ku hiqet materiali i butë. Guri i thyer rrafshohet dhe ngjishet me rul.



Pamje nga zgjerimi i magjistrales M2 në segmentin rrugor Prishtinë – Lipjan me gjatësi 16 km. Punimet janë duke i kryer disa kompani. Njërën pjesë e kryen kompania "ALKO Impex" nga Prishtina, kurse pjesën tjetër e kryejnë kompanitë "Eurokos" Prishtinë, "Integral" Prishtinë dhe "Ital" nga Gjilani.



Ndarja e kufijve të rrugës, e cila pritet të zgjerohet. Gjerësia e kësaj magjistrale do të jetë 28 metra gjithsej. Përpos gurëve anësorë dhe trotuarit kjo rrugë do të ketë edhe kanalizimin e ujërave atmosferike.



Rruga do të jetë me dy kahe nga dy shirita, secila do të ketë nga 7 metra gjerësi, dhe dy shirita ndihmëse me gjerësi 5.5 metra, si dhe dy trotuare anash që kapin një gjerësi prej 3 metrash.



Menaxheri i projektit të kompanisë "Alko-Impex", Rexhep Kamberi, thotë se punët janë duke shkuar sipas dinamikës së rregullt, por ka raste kur punohet edhe natën.



Edhe kjo rrugë parashihet të zgjerohet në të dy anët me një shirit ndihmës 5.5 metra të gjerë. Rruga ka filluar së ndërtuari me 7 prill dhe pritet të përfundojë më 15 korrik 2008.

Përgatiti:
Osman D. GASHI

Çrregullimi autik

Sipas klasifikimit ndërkombëtar të sëmundjeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, autizmi shfaqet tek fëmijët para moshës trevjeçare dhe shoqërohet me vonesa në ndërveprimet e tyre shoqërore, në gjuhë, shenja apo lojëra përfytyruese.



Batjar HALILI

Autizmi është një çrregullim i rëndë i funksioneve trunore dhe, për rrjedhojë, i sjelljes njerëzore, që shkakton dëmtim të komunikimit, ndërveprimit dhe përfytyrimit shoqëror. Njerëzit që vuajnë nga autizmi shpesh kanë një rreze të kufizuar interesash dhe shfaqin sjellje dhe mënyra të sjelljes përsëritëse, si dhe kundërveprime të ndryshme, në mjedisin dhe rrethanat e përditshme.

Autizmi është paaftësi zhvilluese e përjetshme, e cila ndikon në mënyrën se si personi komunikon dhe sillet me njerëzit rreth tyre. Fëmijët dhe të rriturit me autizëm e kanë të vështirë të krijojnë afërsi me të tjerët në mënyrë të thjeshtë. Në përgjithësi, aftësitë e tyre për të zhvilluar shoqëri dhe aftësia e tyre për të kuptuar shprehjet emocionale të njerëzve të tjerë, janë të kufizuara.

Sipas klasifikimit ndërkombëtar të sëmundjeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, autizmi shfaqet tek fëmijët para moshës trevjeçare dhe shoqërohet me vonesa në ndërveprimet e tyre shoqërore, në gjuhë, shenja apo lojëra përfytyruese.

Karakteristikat e autizmit

Aftësitë komunikative dhe kognitive

Një nga karakteristikat më të spikatura të autizmit është profili i aftësive gjuhësore dhe kognitive. Çrregullimet e gjuhës janë të vazhdueshme, kanë mungesë gjuhe që shoqërohet me një mosinteres të madh për shkëmbim verbal me personat e tjerë.

Pothuajse gjuha mungon, por edhe ne rastet kur shfaqet në moshën 2,5 vjeçare, ajo nuk ka funksionin e komunikimit. Bëhet fjalë vetëm për fjalë pa lidhje, në të cilat kuptueshmëria mungon. Ose ndodh që fjala të thuhet me kuptim, por nuk ka lidhje me situatën.

Ekolalia është shumë e shfaqur te ata. Ata përsërisin disa herë fjalë të ndryshme që kanë dëgjuar dhe kjo nuk është një përsëritje e menjëhershme e asaj që kanë dëgjuar, por një formulim i ndryshëm sipas mënyrës së tyre.

Çdo person me autizëm ka uljet dhe ngritjet e tij gjatë përdorimit të aftësive të tij për të kuptuar informacionin p.sh autikët ndonjëherë shfaqin edhe fenomenin e aftësisë të mësuarit përmendsh. Prindërit pohojnë se fëmija e tyre mund të përsërisë një listë ngjarjesh të kaluara. Për shkak të këtyre ngritjeve disa pohojnë se fëmija ka aftësi normale ose të talentuara kognitive.

Por këto rritje aftësish shpesh janë të shoqëruara me dëmtime në fusha të tjera të funksionimit kognitiv. P.sh megjithëse aftësitë e kujtesës mund të jenë mira, dëmtimet në kujtesën rinjohëse ekzistojnë. Këto dobësi vihen re nga profesionistët dhe prindërit si refuzim për të bashkëpunuar. P.sh për shkak se fëmija mund të qëndrojë duke shikuar një objekt që ai e dëshiron shumë, mungesa e tij për të bashkëpunuar dhe për t'iu përgjigjur personit që e thërret në emër, mund të konsiderohet si një mosbindje e vullnetshme, më tepër se një vështirësi për të përqendruar vëmendjen dhe për ta zhvendosur atë nga një aktivitet në një tjetër.

Aftësitë gjuhësore

Një nga karakteristikat domethënëse te autikët është edhe zhvillimi i vonuar i gjuhës dhe të folurit. Vlerësimet tregojnë se 50% të individëve me autizëm nuk zhvillojnë një gjuhë funksionale dhe komunikative gjatë gjithë jetës së tyre.

Ka një numër autikësh që nuk flasin fare gjatë gjithë kohës, ose rastësisht mund të nxjerrin disa tinguj. Kërkimet kanë treguar se rreth 25% e autikëve, nuk flasin gjatë gjithë jetës, ose flasin fjalë dhe tinguj që kuptohen vetëm nga familjarët e tyre. Këta autikë zakonisht kanë një shkallë të prapambetjes mendore, nga ajo e moderuar në të rëndë.

Perceptimi emocional dhe shprehja

Psikologët kanë vërtetuar se fëmijët autikë kanë shprehje të pazakonta emocionale. Të qeshurit mund të ndodhë gjatë periudhave të ankthit, dhe ata mund të qajnë për arsye të pakuptueshme nga të tjerët. Specialistët e psikologjisë klinike tregojnë se autikët janë më shumë të prirë ndaj shprehjes së emocioneve negative dhe përzierjeve të shprehjeve emocionale, në krahasim me fëmijët me vonesë mendore, apo të zhvilluar normalisht. Buzëqeshja e kombinuar me kontaktin me sy është një shfaqje shumë e rrallë tek autikët. Fusha e kuptueshmërisë emocionale është plotësisht e re dhe jo plotësisht e zbuluar.

Kujtesa

Janë vënë re shumë aftësi të kujtesës tek autikët. Më të veçuarat janë aftësitë në fushën e kujtesës përmendsh. Gjithashtu, autikët shfaqen të kenë një aftësi të mirëzhvilluar të kujtesës vizuale. Studimet kanë treguar se autikët kanë kujtesa afatshkurtra më të mira.

Është hipotetizuar se autikët shpesh angazhohen në të pyeturin e vazhdueshëm, për shkak se ata nuk mbajnë mend nëse e kanë bërë këtë pyetje përpara, apo nëse e kanë marrë përgjigjen.

Vëmendja

Në shkollë dhe në ndërveprimet sociale, fëmijët autikë mund të akuzohen se dështojnë në vëmendjen që duhet t'i kushtojnë diçkaje Ata duken sikur nuk dëgjojnë. Nga ana tjetër, i njëjti fëmijë që mund të injorojë zhurmat e mëdha, mund të dëgjojë mjaft mirë zhurmat e vogla dhe të imta në mënyrë të shkëlqyer.

Funksionet ekzekutive

Sjelljet e tyre mund të jenë jofleksibile dhe ata stresohen edhe prej ndryshimeve shumë të vogla të mjedisit. Ata këmbën-

gulin në ndjekjen e rutinës dhe mund të bëhen kokëfortë, duke u fokusuar në detaje specifike, interesa të ngushta ose sjellje stereotipike përsëritëse.

Përdorimi i gjesteve

Autikët kanë si karakteristikë jo të vonë mungesën e zgjatjes së duarve drejt dikujt tjetër. Autikët nuk i drejtojnë thuajse asnjëherë duart drejt të tjerëve, me qëllimin që ata t'i marrin në krahë, edhe në raste kur e bëjnë nuk e shikojnë tjetrin në sy.

Buzëqeshja

2-3 muaj foshnjat nisin të buzëqeshin ndaj fytyrave që hasin në fushëpamjen e tyre. Shumë autikë e realizojnë këtë gjë. Kjo shpjegohet me faktin se buzëqeshjet e hershme nuk kontrollohen nga e njëjta zonë e trurit që kontrollon buzëqeshet e mëvonshme.

Kontakti me sy

Rreth fundit të vitit të dytë të jetës, të gjithë fëmijët autikë përgjithësisht shfaqin një shkallë të caktuar anormailteti në vendosjen e kontaktit me sy. Vendosja e kontakti me sy me ta është shumë e vështirë dhe shpeshherë nuk realizohet.

Aktivitetet dhe interesat e autikëve

Loja dhe imagjinata

Ata nuk luajnë në mënyrën e zakonshme me të cilën luajnë fëmijët e tjerë. Kjo gjë bie menjëherë në sy. Ata nuk shfaqin interes për të njëjtat lodra në te njëjtin stad zhvillimi, madje vihet re se ata nuk janë të interesuar pas lodrave Shpesh ata vijnë rrotull duke prekur sende të ndryshme, por duke mos u angazhuar me diçka për kohë të gjatë.

Lidhja me objektet

Shumë autikë kanë preferencë për një objekt të veçantë, një lodër, një ngjyrë, një formë të caktuar. Këto mund të jenë sende me karakteristika sensore, të cilit këta autikë i gjejnë shume tërheqës.

Lojës së autikëve i mungon imagjinata. Ata luajnë me lodra duke riprodhuar ato që kanë parë dhe mbajnë mend.

Loja sensoriale

Kjo është forma më e hershme e autikëve (ose sensoro-motor). Ajo përfshin veprime dhe manipulime fizike të mjedisit rrethues.

Në stadin më të hershem këta fëmijë futin çdo gjë në gojë. Mendohet se zhvillimi i tyre është më i ngadaltë dhe ata e lënë më ngadalë këtë stad se fëmijët e tjerë.

Së dyti, autikët priren të orientohen drejt shqisave të tyre edhe pasi mund të kenë zhvilluar mënyra më të sofistikuara eksplorimi të objekteve.

Pandryshueshmëria

Ka të bëjë me një karakteristikë klinike plotësuese. Ajo karakterizohet nga nevoja për të zhvilluar dhe mbajtur pika referimi. Disa fëmijë autikë shkojnë gjithnjë në të njëjtat qoshe për t'u izoluar, të tjerë kërkojnë sende me të cilat ata gjenden më mirë.



Nevoja për ta kontrolluar stabilitetin e kuadrit të tyre quhet "sameness" sipas Kanner. Çdo përpjekje për të ndryshuar elementet e mjedisit përreth, do t'u shkaktonte ankth të papërshkruar, ose do të shkaktonte izolimin edhe më tepër në botën e vetë.

Sterotipi dhe ritualet

Gjestet e stereotipizuar janë karakteristikë për fëmijët autikë: të zgjasin dorën sa të prekin një send dhe më pas ta largojnë atë sa më shpejt që të jetë e mundur, sikur të kishin prekur diçka që shkaktonte djegie. Gjestet ndryshojnë nga një rast në tjetrin.

Zhvillimi social

Një kriter tjetër dallues është edhe ai social. Për autikët niveli i interesit për të tjerët është shumë i ndryshueshëm.

Izolimi

Fëmija autik qëndron i palëvizur dhe shfaq një mosinteresim të plotë. Ai ka botën e vetë, në të cilën ai i përfaqëson sendet dhe objektet e botës së jashtme, ndryshe nga të tjerët. Në këtë kuadër, fëmija nuk komunikon më përmes fjalëve; madje edhe gjestet, mimika dhe emocionet e tij nuk i adaptohen situatës dhe kontekstit.

Ndonjëherë fëmija e lejon veten të udhëhiqet nga i rrituri, po pa marrë pjesë vetë në aktivitet, as nuk tregon ndonjë kundërshtim, në të kundërtën, nëse ne duam që patjetër ai të hyjë në kontakt me ne, ai do të reagojë si ndaj një intruzioni të patolerueshëm. Në këtë moment ne mund të shohim se si fëmija përgjigjet me një mbrojtje të jashtëzakonshme ankthi që i shkaktohet, herë mes vetë mutilimit dhe herë përmes agjitimit apo stereotipave. Gjithashtu, autikët nuk ndiejnë nevojën për përforcim social.

Kërkimi i afektit fizik

Autikët kanë mënyra karakteristike për të shfaqur afeksionin fizik ndaj të tjerëve.

Ata mund të jenë shumë të dashur fizikisht, por në mënyra shumë të ndryshme nga të tjerët. Një përqafim me një fëmijë normal shoqërohet me fjalë, për autikët kërkojnë të përqafohen vetëm kur duan dhe kjo zgjat aq sa ata duan të zgjasë.

Mungesa e lojës sociale

Autikët bien në sy shumë të vegjël (rreth 2 vjeç) kur vërehet që diçka nuk shkon në lojën e tyre me të tjerët. Autiku nuk i kupton llojet e komunikimit që vendosen mes fëmijëve kur ata luajnë dhe kështu përpjekjet e tyre për t'u përfshirë në lojë dështojnë. Mungesa e shfaqjes së lojës me të tjerët dhe qëndrimi larg tyre është një karakteristikë dalluese e këtyre fëmijëve.

Marrëdhëniet me moshatarët

Mungesa e miqve dhe e shokëve për autikët është një shenjë dallues që tregon se diçka nuk shkon mirë. Autikët duket se nuk i shikojnë fëmijët e tjerë si gjeja më interesante për ta. Edhe ata autikë që mund të kenë funksion më të lartë komunikativ, kanë vështirësi ta konsiderojnë dikë si mik apo shok të ngushtë. ■

Autori është psikolog.

Histori Islame (18)

Ekspedita e fundit e Muhammedit s.a.v.s. (Beteja e Tebukut)

Çlirimi i Mekës ishte fitore e madhe, por masa e gjerë sikur nuk besonte se muslimanët kishin korrur fitoren përfundimtare. Por, me kthimin e suksesshëm nga Tebuku, asnjë nga fiset e Gadishullit nuk e kundërshtoi më rregulloren e shtetit të ri. Tani po vinte koha që të tëra fiset e Gadishullit të dërgonin përfaqësuesit e tyre që ta njihnin shtetin Islam dhe këto fise i këshillonin përfaqësuesit e tyre që të merrnin mësimet elementare për të filluar një jetë të re, të bazuar në urdhrat Hyjnore.



Muhamed JUSUFI -KAJOLLI

Pas çlirimit të Mekës dhe lëvizjeve të gjata të ushtrisë, e cila korri fitore të njëpasnjëshme, Muhammedi s.a.v.s. bëri umren dhe u kthye në Medinën e shndritshme. Ky kthim kishte ndodhur në ditët e fundit të vitit të tetë hixhri. Deri në fund të këtij viti, mund të themi lirisht se shteti i formuar i muslimanëve ishte vetëm një ide, sepse ai nuk ishte konsoliduar si tërësi shtetërore. Prandaj, me të drejtë, mund të thuhet se fillimi i vitit të nëntë hixhri, ose viti i 630-të, ishte viti që shteti Islam vendosi themelet e qëndrueshme të tij.

Siç kemi thënë edhe më herët, Muhammedi s.a.v.s. nuk ishte as neglizhent, as nihilist. Ai ishte shumë efikas dhe i papërtueshëm. Kështu, me t'u kthyer në Medinë ai caktoi individët që do të merreshin me vjeljen e taksave (xhizjes) nga fiset të cilat ishin nën mbrojtjen e ushtrisë, ose më saktë shtetit të ngritur nga Muhammedit s.a.v.s.

S'do mend se ky organizim, kaq i shpejtë dhe me përmasa kaq të mëdha, do të binte në sytë e perandorisë së Bizantit. Kjo perandori e kishte të freskët fërkimin me një grup të vogël muslimanësh në Mu'te, para pak më shumë se një viti. Për një kohë relativisht të shkurtër, informatorët e perandorisë kishin vënë alarmin, duke thënë se fiset e shkretëtirës së Gadishullit Arabik ishin bashkuar. Ky lajm do t'i vinte në lëvizje mbretëritë e tjera arabe, që ishin shtete vasale të perandorisë bizantine.

Gjithashtu kemi theksuar se Muhammedi s.a.v.s. kishte dërguar në Mu'te (kundër Bizantit) një ushtri prej 3.000 ushtarësh për t'u hakmarrë për emisarin që ia kishin mbytur gassanitët (mbretëri arabe, vasale e Bizantit), por kjo betejë kishte përfunduar pa fitues. Në raste të tilla, të dy palët e kishin të qartë se një ditë do të përplaseshin, por në këtë rast takimi do të ishte shumë më fuqishëm dhe me pasoja të mëdha.

Bizanti filloi të përgatiste një ushtri të madhe, menjëherë pasi informatorët dhanë alarmin se Muhammedi s.a.v.s. kishte triumfuar në Mekë dhe në qytetet përreth saj. Informatorët morën instruksione që të informonin për çdo detaj e për çdo risi brenda lëvizjeve mulimane sepse muslimanëve u duhej dhënë goditja vdekjeprurëse. Prezenca e tepërt e informatorëve i kishte shtuar të dyshuarit nga radhët e muslimanëve të rinj. Flitej se në shoqërinë muslimane ishte shtuar numri i hipokritëve. Në ndihmë të këtyre hipokritëve ishin edhe krerët e fiseve, që akoma nuk e kishin përcaktuar qëndrim e tyre ndaj shtetit të ri. Prej fiseve më të interesuara ishin ato të veriut të Gadishullit Arabik, sepse atyre ju kanosej rreziku më i madh. Pozita e tyre gjeografike kishte bërë që ata të ishin më të vëmendshëm se sa rrethet e tjera. Këta jetonin midis perandorisë më të fuqishme të kohës që kishte një përvojë të gjatë dhe, si e tillë, ajo ju shkonte përshtat të gjithë mbretërve që ishin të interesuar ta mbanin gjendjen e stabilizuar, por, në anën tjetër, këtyre ju kanosej rreziku nga një fuqi e re, e cila sapo kishte lindur një qeveri që po përfitonte, çdo ditë e më shumë, masën e thjeshtë si rezultat i prezantimit të drejtësisë dhe vlerave të tjera njerëzore.

Viti i shfajësimit

Vitin e nëntë të hixhretit muslimanët e quajtën 'vit i shfajësimit', sepse në Kur'an zbriti një kaptinë me emrin Beraetu ose Teube, e cila flet gjerë e gjatë për situatën e krijuar. Kjo kaptinë tregon se cili duhej të ishte qëndrimi i muslimanëve në rrethanat e tilla.

U quajt 'vit i shfajësimit' edhe për faktin se këtë vit shoqëria muslimane e Medinës do të ndahej një herë e mirë: do të dilnin haptazi intriguesit e hipokritët dhe të tjerët që ia donin të mirën Islamit.

Muhammedit s.a.v.s. i vinin, gjithashtu, informacione nga tregtarët arabë për përgatitjet dhe synimet bizantine. Me të marrë lajmin se për një kohë relativisht të shkurtër ushtria bizantine do të depërtonte në brendi të shtetit të ri, ai dha kushtrimin. Ndërkohë që ushtria muslimane po përgatitej, Muhammedi s.a.v.s. vendosi që ta dërgonte këtë ushtri sa më në veri të vendit. Ai nuk dëshironte që beteja të zhvillohej në brendi të shtetit, e aq më tepër në Medinë, sepse kjo nënkuptonte një humbje me pasoja katastrofike.

Përgatitjet për betejën e madhe kishin filluar nga të dy palët, ndërkohë që Muhammedi s.a.v.s., krahas saj, ishte i interesuar që t'i përfitonte sa më shumë zemrat e arabëve të veriut që edhe ata ta përqafonin Islamin si fenë e tyre. Kjo orvatje nuk i shkoi huq, sepse masa e thjeshtë çdo ditë e më shumë po e pranonte konceptin e ofruar nga muslimanët. S'do mend se shumë prej tyre hezitonte nga frika se mos perandori Herakli do të fitonte kundrejt ushtrisë muslimane, prandaj edhe ishin të përmbajtur në vendimet e tyre.

Ushtria familjare

Mobilizimi i përgjithshëm dhe kushtrimi për të luftuar Bizantin i trimëroi edhe më shumë besimtarët e paluhatshëm. Muslimanët do të luftonin kundër Bizantit, ndërsa, komandanti i

kësaj ushtrie do të ishte vetë Muhammedi s.a.v.s. Të gjithë ata që e njihnin dhe e besonin pa mëdyshje të dërguarin e All-llahut, ishin të bindur për fitoren e tyre. Ata mezi e prisnin këtë ditë dhe jepnin të entuziazmuar prej pasurisë së tyre gjithçka që kishin. Mobilizimi nuk ishte i lehtë. Shteti i ri nuk kishte buxhet të mjaftueshëm sa të financonte një ushtri të madhe që do të përballej me perandorinë më të madhe të kohës, prandaj Muhammedi s.a.v.s. kishte kërkuar prej secilit musliman që të jepte aq sa kishte mundësi. Për të mësuar rreth këtij mobilizimi duhet të lexohet me vëmendje kjo kaptinë e Kur'anit të madhërishëm dhe aty do të shihet se sa kishte ndikuar shpallja Hyjnore në vendimet e muslimanëve. Gjithashtu, aty shihet se cili ishte qëndrimi i shtetit islamit për dënimin e hipokritëve.

Historianët na sjellin për ilustrim të dhëna rreth donacioneve. Meqenëse arabët (muslimanët) tani e kishin kuptuar rëndësinë e luftërave të Muhammedit s.a.v.s., çdo individ dëshironte të ndihmonte me maksimumin e mundshëm të tij. Do të mjaftonte të sillnim pak shembuj nga shokët e tij më të afërt. P.sh. Ebu Bekri r.a. dha tërë pasurinë që kishte, ndërsa Osmani r.a. dha mbi nëntëqind deve të mbushura me mall dhe mbi njëqind kuaj për kalërim. Kështu, pa kursyer asgjë nga vetja, kishin vepruar edhe Abdurrahman bin Auf dhe të tjerët...

Në anën tjetër, jomuslimanët dhe hipokritët ishin shumë aktivë në thurjen e intrigave dhe përhapjen e dizinformatave kundër Muhammedit s.a.v.s. dhe muslimanëve në përgjithësi. Propaganda e tyre ishte e logjikshme dhe shumë bindëse, sepse kishin të bënin me një ushtri që ishte pa konkurrente në atë kohë.

Me gjithë vështirësitë e mobilizimit, Muhammedi s.a.v.s. arriti të tubonte një ushtri prej 30 mijë vetash. Asnjëherë më parë në historinë e këtij Gadishulli nuk ishin tubuar kaq shumë njerëz për të luftuar. Ky masivitet flet për situatën dhe gjendjen e re të formuar në këtë Gadishull, prandaj Muhammedi s.a.v.s. e quajti këtë ushtri 'ushtria familjare'. Pra, ai (a.s) e kishte konsideruar këtë ushtri si një familje, sepse në mesin e tyre kishte njerëz që nuk kishin arritur të siguronin kafshë për transportimin e gjërave të nevojshme për këtë rrugëtim të gjatë dhe të vështirë. Thuhet se një deve e kishin përdorur deri në tetëmbëdhjetë vetë.

Tebuku

Në atë kohë, nga Medina deri në Tebuk shkohej për dy javë. Sidoqoftë, kjo ushtri masive arriti përfundimisht në Tebuk me shumë peripeci, të cilat janë përshkruar nëpër libra të ndryshëm të historianëve dhe islamologëve. Muhammedi s.a.v.s. vendosi që ta priste ushtrinë bizantine në këtë qytetet, por ushtria kundërshtare nuk u paraqit për një muaj rresht. Kur muslimanët u bindën se ushtria kundërshtare nuk do të paraqitej, ajo u kthye për në Medinë.

Gjatë qëndrimit të Muhammedit s.a.v.s. në veri të Gadishullit Arabik, pra, në Tebuk dhe rrethinën e tij, ushtria muslimane ishte sjellë si ushtri me virtyte të larta, thuajse si t'i kishte përpara vetes të gjitha konventat e luftës së kohëve të sotme. Jo për t'u mburrur, por rregullat e sjelljeve të ushtrive në botën e sotme e kanë zanafillën nga rregullat e ushtrisë muslimane. Nëpër shkollat tona, fatkeqësisht, nuk tregohet se rregullat që disponojmë sot janë praktikuar shumë herët nga muslimanët. Unë nuk arrij ta kuptoj pse politika dhe diplomacia e shekullit tonë i fshehin këto fakte. Pse duhet që studentët tanë të mësojnë historinë e diplomacisë duke filluar vetëm nga dy shekujt e fundit. Faktet historike nuk fshihen asnjëherë. Ato mund të vonohen por nuk fshihen. Është për të ardhur keq se sa herë që duhet të falënderohen muslimanët thuhet se nuk kemi informacion dhe nuk i dimë këto fakte.

Gjatë qëndrimit të ushtrisë muslimane në Tebuk, te ata kishin arritur shumë delegacione të fiseve të ndryshme. Qëllimi i ardhjeve të tyre ishte që të siguronin pozitën e tyre në shtetin e ri, sepse tani çdo gjë ishte e qartë. Ushtria bizantine nuk kishte më forcë të përballej me një ushtri të madhe e të re dhe me luftëtarë që përjetonin kënaqësinë e tyre më të madhe kur binin shehidë.

Muhammedi s.a.v.s. lidhi traktate me secilin delegacion që kishte shkuar tek ai. Si shembull do të sjellim traktatin me Juhannet (Jovanit) b. Ru'beti, i madhi i Ilijes. Si përfaqësues, ai i siguroi shtetit të ri se do ta paguanin tatimin vjetor – xhizjen, sipas rregullave të para të jurisprudencës së muslimanëve. Ja garancia e dhënë nga Muhammedi s.s.v.s.:

Bismil-lahir-Rahmanir-Rahim

"Kjo është garancia nga All-llahu dhe nga i Dërguari Tij, Muhammedi, dhënë Juhannet b. Ru'betit dhe banorëve të Ilijes. Të gjithë janë të lirë të qarkullojnë nëpër tokë e nëpër det. Ata kanë kontratë nga All-llahu dhe i Dërguari Tij, sikurse edhe ata që janë me ta nga banorët e Shamit dhe nga banorët e bregut të Detit të Kuq. Kujtdo prej tyre që shkakton prishjen e kontratës, do t'i konfiskohet pasuria dhe ai do të gjykohet. Ata që do t'i përmbahen kontratës do të kenë një jetë më të mirë, sepse askush nuk guxon t'ia ndalojë ujin tjetrit, as udhëtimin e tij, qoftë në tokë ose në det". *(Mubarekfuri, Safijurrahman, Nektari i vulosur i xhenetit f.519)*

Ushtria muslimane qëndroi në veri, në Tebuk, aq kohë sa qe e mjaftueshme për t'u siguruar se këto vise po shkonin drejt integrimit në shtetin e ri islam. Pastaj Muhammedi s.a.v.s. u kthye në Medinë ku u prit me shumë gëzim. Ia vlen të theksojmë se, gjatë kthimit, disa individë shfrytëzuan nga rasti i entuziazmit të muslimanëve dhe u përpoqën që t'i bënin atentat Muhammedit s.a.v.s. Atentati nuk pati sukses dhe, që nga ai moment, muslimanët iu desh të ishin më syçelë ndaj hipokritëve. Tani e tutje, gjendja e intriguesve filloi të keqësohej edhe më shumë. Ndërkohë, ata filluan të frikësoheshin se mos Muhammedi s.a.v.s do të hakmerrej. Edhe pse emrat e hipokritëve njiheshin nga muslimanët, e vetmja gjë që iu kërkua atyre ishte që të pendoheshin dhe t'i ktheheshin sërish realitetit të ri. Atyre iu ofrua që të qëndronin dhe t'i gëzonin të mirat si gjithë të tjerët dhe iu kërkua që të mos tentonin të thurnin komplote të reja sepse një gjë e tillë do të ishin fatale për ta.

Çlirimi i Mekës ishte fitore e madhe, por masa e gjerë sikur nuk besonte se muslimanët kishin korrur fitoren përfundimtare. Por, me kthimin e suksesshëm nga Tebuku, asnjë nga fiset e Gadishullit nuk e kundërshtoi më rregulloren e shtetit të ri. Tani po vinte koha që të tëra fiset e Gadishullit të dërgonin përfaqësuesit e tyre që ta njihnin shtetin Islam dhe këto fise i këshillonin përfaqësuesit e tyre që të merrnin mësimet elementare për të filluar një jetë të re, të bazuar në urdhrat Hyjnore. ■

Begatia e shëndetit nga këndvështrimi i Muhammedit a.s.

Kush thellohet më tepër në jetën dhe në veprën e të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s. ndeshet me një transformim misterioz nga historia e thatë, sterile e boshe, që i ngjason shkretëtirës, në një histori të begatë porsi toka e pasur e pjellore, nga e cila mbin e më vonë rritet njerëzorja, dituria, qytetërimi, kultura, civilizimi dhe bukuria.



Ali F. ILJAZI

Jetëshkrimi i të Dërguarit të All-llaut s.a.v.s. gjithnjë do të jetë pikëvrojtim historik, burim i pashtershëm nga i cili do të frymëzohen gjeneratat e reja, kureshtarët e etshëm që janë trashëgimtarët e pejgamberisë, pishtarët e besimit, flakadani i të cilëve do të flakërojë përgjithmonë, e aureola e dritës të së cilëve do të përhapet vazhdimisht.

Kush e ka studiuar me përkushtim rrugën e jetës së të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s. dhe i ka kushtuar rëndësi të mjaftueshme vlerave të tij ideore, meditative dhe praktike, sheh zinxhirin e pashkëputur të ngjarjeve interesante dhe të jashtëzakonshme historike, në të cilat i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. dhe një grup i vogël besimtarësh kanë mbizotëruar qysh në atë kohë shumë njohuri shkencore. Prejardhja e materies, shkaqet e gravitacionit të Tokës dhe shumë njohuri të tjera nga Kur'ani ua kanë ngritur atyre njerëzoren në shkallë të paparë dhe të panjohur deri atëherë në gjininë njerëzore. Kush thellohet më tepër në jetën dhe në veprën e të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s. ndeshet me një transformim misterioz nga historia e thatë, sterile e boshe, që i ngjason shkretëtirës, në një histori të begatë porsi toka e pasur e pjellore, nga e cila mbin e më vonë rritet njerëzorja, dituria, qytetërimi, kultura, civilizimi dhe bukuria.

Nga burimi i të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s. njerëzit shuajnë etjen, nga kopshti i tij i trëndafilave ata vjelin frute dhe lule aromatike.

Historia e deritanishme nuk njeh personalitet si ai i të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s., që ka pasur durim në fatkeqësi, qëndrueshmëri në drejtësi, karakter të fortë dhe të qetë, në vrungullimat e tundimet e kësaj bote.

Tërë jeta e të Dërguarit të All-lldhut s.a.v.s. është caktuar dhe rregulluar sipas dispozitës hyjnore. Kjo i ngjason bimës e cila merr dritën e Diellit nga qielli, pa të cilën nuk mund të ketë jetë.

Çdo fjalë dhe çdo mendim i të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s. përmban në vetvete porosi. Ai ka zgjidhje për çdo problem, ofron shtegdalje nga çdo situatë e vështirë dhe udhëzon shtigjet e ndriçuara në të cilat duhet ecur. Fjalët e tij janë formulë, sipas së cilës njeriu duhet të jetojë. Hija e tij duhet ta ndjekë atë, si ndërgjegjja që udhëhiqet nga arsyeja. Ne me vetëdije nuk mund t'i ikim hijes sonë, e as ndërgjegjes sonë, andaj me vetëdije nuk guxojmë të largohemi nga i Dërguari i All-llahut s.a.v.s.

Fjala e të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s. është thënë ose është shprehur për të bartur domethënien a porosinë e cila duhet të jetësohet. Ai flet me zemër, e cila rrezaton iman dhe me Kur'an. Pas fjalëve të tij qëndron All-llahu i Lartësuar.

Shpirti nuk mund të fluturojë dhe të ngrihet në lartësi, për aq kohë sa njeriu nuk e kupton qëllimin e lindjes, të jetës, të vdekjes dhe të ringjalljes së vet.

Këtë mund ta kuptojë vetëm ai që ka pasur për pejgamber, Muhammedin a.s. Fjalët e tij forcojnë besimin e njeriut. Ato rrezatojnë dritë dhe japin shpresë. Dashuria ndaj tij na ngrohë zemrat dhe na jep fuqi e vullnet për të jetuar, na jep kurajë që të mos humbasim guximin, të mos ligështohemi dhe të mos rrëshqasim në abiset e errësirës.



Fara e zezë, qimoni i zi (Nigella sativa, habbetus sevda)

Për çdo sëmundje të cilën e ka dhënë All-llahu, Ai e ka përcaktuar edhe ilaçin

Muhammedi a.s. ka treguar se ekzistojnë dy lloj diturish: dituria për fenë (dituria religjioze) dhe dituria për trupin. Ai ka thënë: "Për çdo sëmundje që ka dhënë, All-llahu ka përcaktuar edhe ilaçin" (Buhariu).

Kjo thënie e fuqizon shpirtin e pacientit dhe e trimëron mjekun për të kërkuar dhe hulumtuar "ilaçin e vërtetë". Në realitet kur pacienti ndien se ka ilaç të vërtetë për sëmundjen e tij, shpirtin e tij e prek fryma shpresëdhënëse, i mënjanohet brenga dhe i kthehet fuqia për ta mposhtur sëmundjen.

Para 14 shekujve, ai tregoi shumë masa preventive që kishin si qëllim ruajtjen e shëndetit të njeriut, të cilat sot po i vërteton mjekësia bashkëkohore. Në lidhje me këtë Muhammedi a.s., ka thënë: "Nëse dëgjoni se ka rënë murtaja në ndonjë vend, mos hyni aty, por nëse ajo ka rënë në vendin ku jeni ju, mos ikni prej andej" (Buhariu).

Ndalesa e të Dërguarit të All-llahut, që njerëzit të mos i afrohen vendit të përfshirë nga murtaja, është parandalimi më i mirë kundër përhapjes së mëtejme të saj, si edhe këshilla e tij: "Ikni nga lebrozi, sikurse ikni prej luanit".

Përveç masave preventive në ruajtjen e shëndetit, Muhammedi a.s. ka nxitur shërimin alternativ të shumë sëmundjeve. Kështu ai këshilloi shërimin me farën e zezë, qimoni i zi, karragati (Nigela sativa, ar. habbetus - sevda), për të cilën ka thënë: "Përdorni rregullisht farën e zezë, sepse ajo përmban në vete ilaç për çdo sëmund-

Përveç masave preventive në ruajtjen e shëndetit, Muhammedi a.s. ka nxitur shërimin alternativ të shumë sëmundjeve. Kështu ai këshilloi shërimin me farën e zezë, qimoni i zi, karragati (Nigela sativa, ar. habbetus - sevda), për të cilën ka thënë: "Përdorni rregullisht farën e zezë, sepse ajo përmban në vete ilaç për çdo sëmundje, përveç vdekjes".

je, përveç vdekjes".(Buhariu 10/121; Muslimi, 2215)

Drejtoria për kontrollin e ilaçeve dhe ushqimit në SHBA, në vitin 1966, ka lejuar përdorimin e vajit nga fara e zezë, për trajtimin e sëmundjeve kancerogjene, parandalimit të efekteve të padëshiruara të kemoterapisë dhe forcimit të sistemit imunologjik të organizmit.

Shkencëtarët sot kanë zbuluar se kokrra e kimit të zi është shumë e pasur me selen. Ushqimi ynë dhe i evropianëve është e varfër me selen dhe mungesa e tij shkakton probleme shëndetësore. Seleni jo vetëm që është një mineral antioksidativ, por luan rol të veçantë në rregullimin e tajitjes së hormonit testosteronit.

Mungesa e selenit shkakton rënien e flokëve, miopati dhe artritis. Një njeri me peshë 65 kg ka nevojë për 21 mikrogramë selen në ditë. Mungesa e selenit nën 19 mikrogramë në ditë shkakton dobësim të muskulit të zemrës (kardiomiopati).

Kokrra e kimit të zi rrit imunitetin, është ilaç antisklerotik, karminativ, rregullon peristaltikën, forcon muskujt (veçanërisht muskulin e zemrës), qetëson dhe lehtëson sëmundjet reumatike, është antikancerogjen, rregullon proceset oksidoreduktive, dhe vendos ekuilibrin e sistemit endokrin.

Mjalti dhe aloa vera - ilaçe të lavdëruara nga i Dërguari i All-llahut s.a.v.s.

Muhammedi a.s. para 14 shekujve ka treguar edhe një mënyrë efikase të shërimit – lëshimi i gjakut (flebotomia) me anën e prerjes së lëkurës në kupëzore (shishe me grykë të ngushtë ku rrjedh gjaku). Ibn Abbasi ka shënuar se i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. ka thënë: "Është i bekuar ai rob që lëshon gjak me anën e prerjes së lëkurës (hixham)". Kjo pastron gjakun, qetëson pezmatimet e brendshme dhe forcon të parit.

Sot kjo metodë shërimi aplikohet në shumë shtete dhe është tejet efikase për këto sëmundje: tensioni i lartë, sëmundjet kardiovaskulare, cerebrale (parapengon insultin cerebrovaskular), sëmundjet e veshkave, prostatës, diabetit, kokëdhembjet, etj.

Hixhami (cupping) bëhet sot në mënyrë tërësisht legale në Kinë, Finlandë, Greqi, Francë dhe shumë vende të tjera të botës.

Ilaçet të cilat i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. i ka lavdëruar në mënyrë të veçantë janë: mjalti dhe aloa vera.

Ummu Kajs bint Mihsan ka thënë: "Kam dëgjuar Pejgamberin s.a.v.s. duke thënë: "Shërbehuni me drurin e alojës, sepse ajo është shëruese për shtatë sëmundje, mes së cilave edhe inhalimi në hundë tek dhembja e kokës, veçanërisht te inflamimi i pleurës (pleuriti)".(Buhariu, Sahih - "Kitab el tibb", nr.5260).

Një rëndësi të veçantë në ruajtjen e shëndetit dhe mbajtjes se vitalitetit, Muhammedi a.s. i jep fikut dhe ullirit.

Para një viti Prof.dr. Taha Ibrahim, profesor i biologjisë në Universitetin e El – Ez'her, zbuloi si një shkencëtar japonez nga lëmi i bujqësisë pranoi islamin pasi zbuloi një mrekulli nga Kur'ani. Hulumtuesi i tij shkencor trajtoi efektet shëruese të fikut dhe ullirit. Dr. Taha Ibrahim thotë: "Një substancë e quajtur methaleutanids sekreton truri i njeriut dhe kafshëve në sasi të vogla. Ajo përbëhet nga proteinat dhe përmban sasi të vogla të squfurit. Kjo substancë lidhet lehtë me zinkun, hekurin dhe fosforin. Kjo materie është tejet e rëndësishme për jetën e njeriut, sepse zvogëlon nivelin e kolesterolit dhe rregullon metabolizmin, forcon muskulin e zemrës dhe rregullon frymëmarrjen". Profesori konkludoi se tajitja e kësaj substance nga truri fillon gradualisht nga mosha 15 deri 35 vjeçare e pastaj zvogëlohet, sidomos pas moshës 60 vjeçare. Kur u orientuan në gjetjen e kësaj substance magjike, hulumtuesit japonezë në mesin e bimëve gjetën: fikun dhe ullirin.

Por kishte mbetur një dilemë: si ta bënin përzierjen e tyre. Dr. Taha Ibrahim u sugjeroi që ta bënin përzierjen në proporcionin 1:7 në favor të ullirit, sepse në Kur'an, fiku përmendet një herë, ndërsa ulliri shtatë herë. Pasi u vërtetua efikasiteti i këtij ilaçi, grupi hulumtues japonez mbeti i mahnitur me realitetin shkencor të Kur'anit.

Dhe në fund një thënie interesante e Muhammedit a.s:

"Kur gjeli kukuris, lavdëroni Zotin se ai i sheh melekët, ndërsa kur pall gomari, kërkoni mbrojtje nga shejtani, sepse ai sheh shejtanin".

Një oftalmolog i njohur nga Egjipti e shpjegoi këtë kështu: "Gjeli sheh rrezet ultravjollcë, ndërsa syri i gomarit sheh rrezet infra të kuqe. Shejtani është i përbërë nga rrezet infra të kuqe, ndërsa melekët nga rrezet ultravjollcë. Prezenca e jelekut e largon shejtanin. Prezenca e rrezeve ultravjollcë i zhduk rrezet infra të kuqe". ■



Shtegtim deri në agim

Mimoza SINANI

Terri i hollë i mbrëmjes tashmë kishte filluar të pushtonte dhomën. Heshtja e saj kishte diçka të çuditshme dhe fytyra e saj tregonte se ajo ndrynte diçka në shpirt. Një plogështi e jashtëzakonshme ia përshkroi trupin. Çdo gjë iu duk e çuditshme, madje edhe vetja. I erdhi më mirë të rrinte pranë dritares dhe u mbështet në mbështetësen e madhe të karriges.

Hodhi vështrimin nëpër dhomë. Të gjitha sendet iu dukën me një pamje të pikëlluar dhe të strukura në qetësinë e vet. Edhe ajo hyri e struk më brenda në lëkurën e vet.

Një tis i vazhdueshëm shqetësimi dhe një mjegull e padukshme trishtimi dukej në sytë vjeshtorë të saj. Zhurma e erës që trazoi qetësinë e dhomës së saj e bëri edhe më shurdhuese zhurmën e heshtjes së saj. Qetësia ishte qepur me penjtë e kësaj heshtjeje të rëndë dhe të palëvizshme. I pëlqente të meditonte dhe të zhytej në trazirat shpirtërore, dilemat, misteret.

Kishte dëshirë të përsiaste me veten. Ndjeu se po delironte e ulur aty pranë dritares e rrëmbyer nga kujtimet që rendnin në kohë. Mendimet e saj po shtegtonin në një depo kujtimesh që tashmë iu dukën sikur kundërmonin aromë vjetërsie.

Një rrymë ajri trazoi syprinën e ujshme të kujtimeve dhe e përfshiu në afshin e tyre. Ndjeu mërmërimën e mendimeve dhe iu duk se jehona e tyre u përhap në eter.

Kërkonte të lexonte fragmente të bukura të jetës, por ato shushuritnin me një gjuhë të pakuptimtë, thuaj fantazmagorike.

Një heshtje e tejdukshme endej nëpër dhomë. Heshtjen e saj nuk e trazoi as fëshfërima e gjetheve që sikur përpiqej të griste perden e qetësisë. Rrezet e mekura të hënës dukeshin si të skllavëruara nga zërat misteriozë të qiejve.

Kujtimet e shtrydhura në morsën e kujtesës filluan të avullonin dhe t'i përplaseshin humnerave të shpirtit. Qëndronte e pafuqishme përpara asaj hapësire aq të pakufishme që ngrihej mbi greminat e shpirtit.

Një enigmë e mbërthyer dhe e burgosur brenda saj kërkonte të rendte, të çmbështillej e të çlirohej. Në atë çast, mendimet iu ndalën, iu këputën dhe iu shterën. Por dëshira nuk e la. Desh ta vazhdojë kërkimin por mendimet iu përzien dhe iu shndërruan në një shkarravinë kolosale të pakuptimtë vijash të ndryshme, si hieroglifë të pakuptueshëm, që lakonin, dredhonin e zhdukeshin në labirinte pa rrugëdalje.

Çdo gjë iu duk tepër e ngatërruar, nuk shihte tjetër përveçse një pështjellimi të pashoq. Por ishte e sigurt se edhe tek labirintet pa fund e pa krye gjendej një rrugëdalje.

Syprina e ujshme e kujtimeve të saj u përfshi nga trazirat e një ere të papritur. Ishte bërë pre e mendimeve të kaluara që tërhiqeshin për t'u rikthyer prapë si fosile që ringjallen. Hijet e së kaluarës po i afroheshin duke u luhatur nga erërat e kohës. Ishte zhytur në ujërat e thella të deteve të zemrës dhe i dukej së bashkë me të edhe e tërë bota ishte zhytur në një natë universale.

Iu duk vetja e zbrazët, e shkretë, e zhytur në terrishte. Po jetonte në skutat e një vetmie trishtuese si një trumcak i vetmuar në një holokaust dimri.

Objektet e natyrës nuk përbënin asgjë më shumë sesa figura të pajeta pjesëmarrëse në një paradë të pakuptimtë. Ekzistenca në tërësinë e saj ishte fragmentarizuar dhe pjesët e saj, të shkëputura nga shpirtërorja, ishin të huaja për njëra tjetrën.

Në fëmijëri kishte krijuar imazhin e saj për jetën, plot mahnitje e rrëzëllime yjësie, plot ishuj ekzotikë valëzues e shkumues, plot dritësi e nanurisje, plot fosforeshencë dhe pllaja ëndrrash, plot shkëmbinj koralesh të zhytur në ujëra transparentë tërë dritë e ngjyra, plot pranvera me kurora lulesh përrallore, plot agime mëngjesore me ngjyrë mermeri të trëndafiltë, por më pas plot drithërima trembjeje dhe enigma.

Universi i librave të mrekullueshëm artistikë, të autorëve të shquar klasikë e modernë, dhe tingujt e ëmbël të "Flautit magjik" "Bukuroshes së fjetur, "Liqenit të Mjellmave" dhe simfonive të tjera melodioze, ishin si zëra sirene që e kishin magjepsur deri atëherë.

Mendimet po i luanin një vals të trishtë. Lumturia e dikurshme iu duk si një mirazh dhe shtojzovalle që ikën tepër shpejt. Jeta i dukej absurde, me ditë që zinin ndryshk, e muaj që pikonin lot. Iu duk vetja si një rreze e purpurt përballë reve të zeza e të rënda, si një lule e sapodalë sipër barit të freskët përballë tankeve të hekurta të luftës.

Shkurtësia e jetës i ishte bërë e pafundme nga prania në të e misterit të vetvetes. Hapja e derës së vetvetes i dukej më e rëndësishme dhe më e guximshme se hapja e çdo dere tjetër, qoftë ajo edhe dera e një kasaforte të mbyllur me shifra të koduara, në të cilën ruheshin thesaret dhe xhevahiret e kësaj bote. Hapja e kësaj dere do ta çonte drejt një të panjohure të njohur që prekej, shihej, fotografohej, kurse ajo që fshihte dera e vetvetes nuk shihej, nuk prekej e as nuk filmohej.

Tendosja iu shkallëzua në një makth alarmant. Ndjeu regëtimat e shpjeta të zemrës që ia drithëruan trupin si një rrëmet sizmik. Ndihej si një qenie hibride mes një mjedisi të dyzuar. Ndiente se erozioni po e gërryente brenda vetes.

I mblodhi kujtimet e saj të shkuara, i groposi si relikte në katafalkun e ëndrrave të saj dhe ua fali flatrave të harresës.

Iu bë se po humbiste brenda vorbullës së dhimbjeve të vdekjes dhe po përpiqej ta çlironte kështjellën e shpirtit nga magjepsjet e Circes. Iu duk se shpirti iu zbardh nga mendimet e thinjura. Pulëbardhat e shpir-



tit kapën fijet e shkëputura të tij dhe po përpiqeshin të fluturonin larg ferrit dantian, larg humnerave të frikshme që kishte projektuar Luciferi.

Gjithçka që i kishte dhënë gëzim e lumturi deri atëherë ishte tretur e zhvlerësuar, ashtu si astrologjia babilonase përballë zbulimeve të dishepujve të Keplerit.

Shqetësimi i saj filloi të shprehej në një mjegullnajë të lehtë lotësh. Qepallat iu vesuan nga lotët. Ndjeu pulsin t'i rrihte si fëshfërima e përplasjes së krahëve të një pëllumbeshe të plagosur. Shkulmet e vajit që dilnin nga shpirti drithëronin edhe xhamat.

Drithërimat e saj reflektonin në xhamat e dritares portretin e saj të shformuar nga frika.

Hodhi vështrimin nga dritarja. Jashtë hapej qielli i mbushur me yje tërë shkëlqim. Pjesët e fytyrës që ndriçoheshin nga hëna hidhnin një hije të zbehtë mbi pjesët e tjera duke e mbuluar atë me një vello dritë-hije dhe fytyra i kishte marrë një shprehje pafajësie. Lotët e frymëzuan dhe ia bleruan shpirtin e shkatërruar, ashtu si pranvera bleron natyrën pas dimrit të acartë.

Papritur një vetëdije hyjnore e mbushi qenien e saj duke davaritur frikën e duke e orientuar në rrugën drejt jetës.

Filloi të bëhej një me ndjenjat e veta dhe të provojë ëmbëlsinë e hyrjes në brendësinë e vet. Kur hyri brenda origjinës së vet, kur arriti të takohej me brendësinë e saj, ajo gjeti dikë tjetër që e donte shumë dhe e kuptoi se ekziston një Zot që e kish krijuar atë dhe botën e saj të brendshme.



Shpirti i saj vazhdimisht pretendonte dhe synonte botën më të lartë shpirtërore, botën e panjohur nga e cila kishte të njohura vetëm disa vegime të cilat shpërndaheshin përpara se të paraqiteshin. Atëherë e kuptoi se ajo botë e panjohur, një refleks shkëlqimi të së cilës e kishte vërejtur në melodinë e ëmbël dhe në tregimin gjenial, dhe që në momentet e inspirimit e kishte ndier aromën e saj, ishte shumë më e fuqishme se kjo botë materiale. Shkëmbi i akullt i egolatrisë brenda shpirtit të saj filloi të shkrijë.

Ishte një kërkim i pareshtur i përgjigjes së kësaj enigme për t'u kthyer sërish në unitetin e përkryer të zanafillës së parajsës së humbur, të rilidhjes përsëri me kordonin amënor.

I dukej sikur ishte duke gërmuar pusin me gjilpërë, por në fakt sapo kishte filluar të qëndiste në gjergjefin e saj lulet e para të besimit.

Pesha e zhdukjes së përjetshme iu hoq dhe arriti të ndiejë dimensionin e pafundësisë së ngulitur brenda thelbit të vet.

Engjëjt e bardhë që i prekën membranën e kujtesës iu përplasën në honet e subkoshiencës si kone drite.

Arriti të perceptojë rrugën dhe destinacionin që kalon nëpërmjet varrit drejt pafundësisë dhe në udhëtimin e saj misterioz e vërteta hyjnore ishte drejtuesja e saj drejt vendit të përjetësisë. Njohja hyjnore, që e grisi perden e hedhur në fytyrën e vdekjes dhe vdekshmërisë, ia tregoi varrin si një sallon pritjeje të botës së lumturisë së amshuar dhe e çoi zemrën e saj të etur për lumturi që të pinte në burimin e eliksirit të pavdekshmërisë.

Pas shtrëngatës, në detin ku kishin ulëritur dhe buçitur furtunat dhe dallgët, tani sundonte vetëm një zë i dëlirë dhe i ëmbël. I tërë deti kishte rënë në qetësi i magjepsur nga ky tingull hyjnor që endej brenda hapësirave të tij të pakufishëm.

Arriti të kuptojë domethënien e të fshehtave që qëndronin prapa vellos së ekzistencës dhe besimi tek Zoti ia ndryshoi dëshirat dhe mendimet.

Shkëlqeu e tëra e ndezur nga një dritë e brendshme. Një ndjenjë e fuqishme dhe sublime ia përshkroi tërë kurmin.

Kapilarët e boshatisur nëpërmjet të cilave organizmit të saj i shpërndahej energjia filluan të furnizoheshin sërish. Ishte njëlloj si lindja e një dielli në një botë ku kishte munguar ajri.

Ndjeu se dalëngadalë po përfshihej nga procesi rrezatues i përsosjes. Ndjeu shkëlqimin e mirësisë dhe vetja iu duk më e bukur, më e mirë.

Dashuria e pafundme për Krijuesin si një oazë llamburitëse shprese i dha forcë.

Filloi të përjetojë kënaqësinë që i dhuronte lutja drejtuar Krijuesit kur rrezet e dritës akoma nuk e kishin çarë perden e natës dhe filloi të freskojë zemrën e zhuritur në lumenjtë e përjetësisë.

Në shpirtin e saj reshën shirat e frymëzimit. Filloi t'i lutet All-llahut: "Falënderimi i takon vetëm All-llahut, Zotit të Botëve ...Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm te Ti ndihmë kërkojmë!"

Fjalët e dala nga goja e saj, të kapura dorë për dore u ngritën duke vallëzuar deri në qiellin e shtatë, trokitën dhe hynë në portën e Mëshiruesit.

Edhe pse përjashta do të frynin e shfrynin rrebeshe, ajo do t'i ujiste dhe kultivonte me kujdes rrënjët delikate dhe të brishta të filizit të besimit që hibridët të mos e hibridizonin pemën e sapo mbjellë të imanit të saj.

Dashuria për Krijuesin madhështor reshi mbi shpirtin e saj, ashtu si reshin shirat e begatë të pranverës mbi tokën e mbetur djerrë dhe ajo u rrok pas stinës së trëndafiltë të frymës muhamediane.

Qielli i pakufishëm u ndriçua nga drita e kulluar e diellit. Hëna po voziste si velë drejt viseve të largëta të botës. Vellot e mjegullave u përhapën dhe mënjanuan dantellat e mëndafshta të reve. Rrezja e dritës filloi të pushtojë hap pas hapi zonat e hijesuara. Syprina e kaltër e reflekseve të qiellit iu derdh mbi fytyrë dhe fashat e ëmbla të dritës depërtuan nëpër dritare. Hodhi vështrimin nga kaltërsia e qiellit, ngriti dorën lart ta prektë atë dhe gishtërinjtë ndien freskinë e ajrit. Ajri ishte i tejdukshëm dhe dukeshin qartë konturet e pemëve të veshura në të gjelbër. Një gjelbërim i ëmbël i lundronte në sy. Mori frymë thellë e etur dhe iu duk sikur nuk do ngopej edhe po të thithte tërë ajrin e hapësirës. Vështrimi i saj i kadifenjtë si një rreze e purpurt sodiste dritësinë e agimit. Tingujt dhe cicërimat që mbushnin hapësirën rezononin një akustikë të ëmbël. Dëgjonte një përzierje tingujsh akustikë dhe metafizikë.

Ishte çliruar plotësisht nga hallkat e ftohta të së kaluarës dhe përgjonte zërin e paqtë të së ardhmes. Kjo vetëdije hyjnore tani ishte gjithçka për të: bota, jeta, lumturia, e tashmja tokësore dhe e ardhmja qiellore. ■

Studim teksti

Shkrimi kah metapërjetimi personal

Fahrudin Shehu këtë mbingarkim të figurës e bën më vetëdije të plotë, sepse do të theksojë tërë atë që është njerëzore, njerëzore që, së pari, është individuale në gjykim, ku individualja në diskursin e tekstit lidhet padyshim më atë që është e arsyeshme në jetë.



Flamur MALOKU

Përmbledhja poetike "Kun" e Fahrudin Shehut, në përgjithësi, si tekst poetik ndërtohet nëpërmjet gjuhës simbolike, pra tërë teksti poetik rikthehet në diskursin simbolik, duke u identifikuar si shprehje dhe si formë ideore në secilën poezi. Dihet se figura simbolike e shtruar në gjuhën e tekstit hap interpretime e rinterpretime të shumta, andaj lexuesi e ka vështirë të kapë kuptimësinë e tekstit në përgjithësi, sepse simboli e bën diskursin tekstor të poezive më shumë shtresor, në secilën formë të shprehjes ideore. Mirëpo, varësisht nga kjo, poezitë janë të hapura në komunikim me lexuesin, varësisht ligjërimit që është i identifikuar dhe i shoqëruar me shprehjen simbolike. Përpos simbolit, edhe figurat e tjera në të gjithë tekstin nuk janë lineare në paraqitje dhe në shënjim, kuptimësia e tyre është e mbingarkuar në theksim. Subjekti këtë mbingarkim të figurës e bën më vetëdije të plotë, sepse do të theksojë tërë atë që është njerëzore, njerëzore që, së pari, është individuale në gjykim, ku individualja në diskursin e tekstit lidhet padyshim më atë që është e arsyeshme në jetë. Qenia njerëzore në këtë jetë duhet të këtë arsyeshmërinë si në kuptimin e sjelljes ashtu edhe të gjykimit, varësisht pengesave që ka jeta. Pengesat e shumta janë të paevitueshme në jetë dhe njëherësh të bëjnë që të mos realizosh shumë gjëra. Prandaj mosrealizimi i këtyre gjërave në jetë dhe në kohë, e bën në këtë rast edhe poetin që të rikthehet në kohë gjërave të parealizuara, po tani vetëm si kujtim, kujtim ky pse jo edhe i dëshpëruar. Mosrealizimi i këtyre gjërave, vetvetiu, është dëshpërues në trupin fizik të kësaj bote. Mirëpo, dëshpërimi subjektiv bëhet edhe më i madh kur preken gjëra intime-personale, kur i referohen një personi të dashur, që ekziston si trup fizik, por që është larg nga subjekti, andaj edhe kujtimi bëhet edhe më i rëndë mbi fatin e parealizueshëm. Fati është i përcaktuar nga Zoti, për secilin individ të kësaj bote. Një gjë të tillë subjekti e ka të qartë, andaj edhe pajtohet me këtë. Tani subjektit i mbetet vetëm të kujtojë, duke mos e zbehur asnjëherë besimin. Pra, e gjithë kjo vetëm sa e përforcon subjektin. Shkurt, ka forcën e përballimit përgjatë këtij rikthimi, andaj edhe në shtresën e tekstit gjykon me vetëdije të plotë, sepse ka besimin në dritën hyjnore, dritë e cila e shoqëron subjektin përgjatë këtij kujtimi:



Fahrudin Shehu

Larg të kam
Kujtimi më vjen si dritë ylli
Shuarjen e të cilit
Dot s'e besoj
Kështu më ka bota
Të hutuar
Tek pres flladi
Ta freskoj
Vesa

Drita e yllit bëhet figurativisht shpresë subjektive, shuarjen e të cilit subjekti nuk e beson, pra bëhet forcim shpirtëror. Forcimi shpirtëror- subjektiv e zbut edhe emocionalitetin përballë asaj që është larg.

E veçanta dhe e përgjithshmja ideore

Kështu, theksimi i një sistemi të këtillë ideor, tanimë i shtrirë në tekst, del si diçka e veçantë dhe e përgjithshme, e veçantia - individualja, çdoherë duhet të ketë vijë komunikimi në besim me të përgjithshmen – Zotin, varësisht fatit të brishtë jetësor, varësisht mallit që ka për atë. Ky njëherësh formon edhe binomin; bindje dhe besim, në të vërteten e fjalës hyjnore, që në këtë rast te subjekti janë të paluhatshme, gjë që bëhet e dituar edhe në fund të poezisë:

Kjo do të bëhet
Mrekulli e përhershme
Fjalë e Perëndisë
Kur thuhet ajo bëhet

E gjithë kjo shprehet simbolikisht me atë se qenia njerëzore patjetër duhet të besojë. Besimi e bën njeriun të mendojë në mënyrë të arsyeshme dhe të veprojë dhe të gjykojë njëkohësisht në mënyrë të arsyeshme. Kjo ide shqiptohet në çdo figurë të përdoruar nga subjekti, edhe pse subjekti ballafaqohet me mallin për atë. Bindja e këtillë subjektive tanimë e njohur në diskursin e tekstit, e bën autorin më të guximshëm të gjykojë në mënyrë shumë precize edhe për personin që asnjëherë nuk e ka njohur të vërtetën hyjnore e jetësore, që subjekti i kishte folur për të në jetë. Çdo fjalë e thënë nga subjekti këtu është e përforcuar nga diskursi i dhembjes, e dalë nëpërmjet shenjave personale. Kjo personale theksohet



dukshëm jo vetëm nëpërmjet shenjave, por edhe nga vetë titulli dy herë i shqiptuar “Unë dhe unë”. Ky titull mund të merret edhe si monolog me vetveten, si unë e shqiptuar dy herë, pra autori përballë autorit, por ajo është thjesht poezi referenciale që i kushtohet dikujt-një personi, se vetë shenjat e dërgojnë tekstin nga referencialiteti:

Ti nuk më beson as mua e as Zotit
Fluturat prej lules në lule shkojnë me vetën në kujtesë
Ti nuk merr mësim as nga unë e as nga ajo vet

Shihet qartë që subjekti i referohet dikujt, referencën e forcon edhe më shumë përemri vetor (ti), kjo ‘ti’ e shqiptuar në shkrimin e tekstit artikulon edhe idenë e vetë tekstit dhe dhembjen që ka subjekti karshi atij personi. Andaj, autori bëhet shumë gjykues ndaj tij, duke e ngritur deri në atë masë edhe besimin, ku edhe trajta e shqiptuar emocionale merr formën e padëshiruar në përshkrim. Duke u theksuar vazhdimisht shprehja personale përballë këtij personi, të cilin subjekti e sheh të pandryshueshëm në kohë dhe në jetë, shpaloset edhe vetë bindja e subjektit në mosndryshueshmërinë e këtij personi, edhe pse autori i flet nga afshi i zemrës me bindje të plotë. Kështu, autori flet vazhdimisht me këtë tip diskursi në të gjithë tekstin, duke shpalosur veten e vetveten si në besim, ashtu edhe në gjetjen e vërtetë: dashuria e tij është ajo që buron nga lart, kjo e mban gjallë autorin. ■

Diskursi kur’anor në letërsinë shqipe(I)

Diskursi kur’anor nuk ka pasur kurrë kriza të mëdha të identitetit dhe nuk është rrezikuar nga tjetërsimi

Muhamed ÇITAKU

Diskursi kur’anor në letërsinë shqipe nuk ka shtrirje të madhe në kulturën e shkrimit, sa në atë gojore. Shikimi i këtij diskursi brenda letërsisë shqipe funksionon me forma të ndryshme, ka transformime në paraqitje, ka komunikim me forma të tjera, etj. Pra, brenda kulturës së shkrimit shqip diskursi kur’anor merr karakteristika të veçanta të shfaqjes, krahas shfaqjes në Kur’an dhe në kultura të tjera. Madje ai varet edhe prej kërkesave të autorëve ku ai përdoret, duke ndërtuar variacione të ndryshme formale. Diskursi kur’anor në letërsi del me funksionin e letërsisë së pastër e jo me funksion fetar. Pra, dallon prej diskurseve të tjera: biblike, heroike, etj., të cilat kanë një fuqi të madhe religjioze dhe etike, kjo ndoshta për shkak të gjendjes sociopolitike dhe kulturore. Diskursi kur’anor nuk ka pasur kurrë kriza të mëdha të identitetit dhe nuk është rrezikuar nga tjetërsimi, nga humbja apo nga ndonjë fuqi sociokulturore.

Diskursit kur’anor tek bejtexhinjtë

Përkufizimi më i shpeshtë i poezive të bejtexhinjve ka qenë se ato janë *“poezi sociale”*. Kjo *“sociale”* ka bartur përkufizimin tematik duke i përjashtuar klasifikimet tjera stilistike, zhanrore, etj. Kjo tregon për praninë e madhe të elementeve sociale në testet e tyre, që bëhen jetike edhe për interpretimin e tyre. Pra, tema e ka orientuar interpretimin, jo artistikja e estetikja. Përkufizimi *"poezi sociale"* tregon edhe për ndërkomunikimin e letrarësisë së tyre me jashtëletërsinë, me rendin kohor dhe vendor. Gjendja sociokulturore e kohës dhe vendit nën Perandorinë Osmane na tregon për referencat lindore dhe kur’anore. Kështu referenca *“sociale”* i ndërlidh poezitë me diskursin kur’anor, duke i bërë karakteristikat e realitetit, karakteristika edhe të poezive. Në ambientin e tillë, kultura islame ishte e pranishme dyfish:

- njerëzit që marrin referencë bejtexhinjtë janë muslimanë,

- ata janë nën administrimin e shtetit islam.

Prej tyre, njëra subjektive (feja e njerëzve) që pranon përkatësinë islame me praninë shpirtëror, e tjetra objektive (administrimi i shtetit islam) që obligon përkatësinë me *shfaqje* dhe *veprim* (veshja, sjellja, etj.). Madje në një administrim të tillë edhe subjektivja e shpallur duhet të jetë në përputhje me atë administrim. Ja si shkruan Zenel Bastari:

Deh o xhan, ç`më zu belaja
Merre vesh në je irfan
Je pa fe më thon dynjaja
Nuk ke dinë as nuk ke iman

Pra e quan bela kur njeriut i thuhet se je *"pa din e iman"*. Kjo tregon për rëndësinë që ka përputhja e tekstit me besimin islam. Kjo përputhje e zgjeron elementin kur’anor në këto poezi, gjersa poezitë bartin referencë objektive. Këto dy karakteristika, subjektivja dhe objektivja, shenjojnë praninë e diskursit kur’anor te bejtexhinjtë në dy forma;

a) diskursi kur’anor del si shpërthim personal dhe

b) diskursi kur’anor te bejtexhinjtë del objektivisht në dy forma;

o islami si ligj i jetës së njerëzve dhe

o islami si simbol se si duhen të jenë njerëzit.

Diskursi kur’anor si shpërthim personal

Në këtë grup hyjnë ato shkrime ku diskursi kur’anor lidhet me subjektin lirik. Në këto raste paraqitet përkatësia islame e autorit duke u rikontekstualizuar konceptet fetare në rrafshin estetik. Ndërsa në nivelin e formave letrare ato hyjnë si:

Lutje – Lutjet realizohen në pajtim me rregullat kur’anore. Tash gjersa poezia i referohet realitetit, edhe lutja vjen në relacion me realitetin ose me autorin. Teksti i tillë në poezi e ndërpret rrëfimin ose përshkrimin dhe kalon në lutje dhe shfrim emocional. P.sh. tek Nezim Frakulla:

Këtë oxhak Zoti na e shtoftë
Me merhamet u forcoftë
Pleq e të rinjë i gëzoftë
Për Muhamed Mustafanë

Lutja bëhet për rregullim jetësor, për rregullim të **sociales** së poezive. Këto janë dëshmi se lutjet nuk bartin kurrfarë moralizimi. Në poezitë e bejtexhinjve ka raste të tilla të mjaftueshme që rimerren shpesh si motive e lajtmotive në funksione të ndryshme dëshire, nevoje, rregullimi etj., përballë realitetit ose subjektit lirik. Ja si del tek Z. Bastari:

Un sillem ktu daim
Bahem ditë bahem natë
Le t‘më falë ai Rahim
Në qoftë se e qis për ispat

Tash, pas shpërthimeve personale, kemi lutjen për mëshirë. Ajo që e shquan këtë tip shkrimi, si lutje personale tek të gjithë autorët, është se realizohet me një sentimentalizëm të fuqishëm, shpeshherë edhe me thirroret si: “Ja Rab”, “O All-llah” etj. ■

Poezi

Në skenën e mërzisë



Shkurtë KADRIU

Dështimi

Mallshëm po zbresim nga qiejt
Në gërryerje të ëndrrave të dikurshme
Po lozin si humbëse shpresat
E fundi po ecën ngadalë
Si stinët në përroin plak
Në fije kujtimesh po tretet
imazhi bosh i jetës
Në largësinë e brishtë
Mes paanësisë
jeta
ngel pa sy.

Me jetën

E ngulfatemi ne
shtrydha ndrydhur
sa herë të do jeta
e zhurma kacavjerrur
në ditë
zënë hapësira të qelqta
E di ti se s' jam unë
e loja paska bisht
që vret e ledhaton
përhershmërisht me ndjekjen
Eh… ç 'më zgjaten këto shtigje…
Më plas në fyt jeta…

Humbje

E qyteti më bëhet X
rrugët më janë fjalë
përdredhur me vetminë
ndiqemi hë për hë…
…e skuqet jeta
në këmishën e krimbur
symbyllas luan fati
në natën e zezë
ëndrrat mjegullohen
e pikë shiu s'ka.

Poesis

Thyhet numëratore kafshimi
E pjerrtas rri koka
… në mur improvizim perdesh
shqyejnë shenjat e fshehta
që vidhen dora-dorës
Libri im ka kokë njeriu.
Po gërvishemi keqas
në harrim ëndërrash
rrotullimthi fjalët çupuriten
shpirtëzojnë ngapak poezinë.
Shpirti im
nuk fal, as vargu im
tundueshëm kapërcen
fjalë që s'pret në mua
përmallshëm lind një shpirt.

Datëlindja

Në lindje e vdekje
tik-taket e orës
ndajnë akerontin në dy brigje
të gurëzuara
lule të heshtura
mësohen me majin
ku lehtësisht puhizat gëlltisin
aromën e ngjarjeve
lepurushe
që ikën nga ne
Kështu…
numëruam njëzet kafka
mbi vorbullë.

Pak poezi

Në mot të vrenjtur
fluturon e verdha shami
Në skenën e mërzisë
mbytet e përmbyset arti
E Borëbardha bredh
zërave të harruar …
me ngjyrat e ëndrrave
Fëmijët me trishtim mbi supe
shëtisin rrugëve të iluzionit
Çdo gjuhë lëpin gjunjët e vet
Arkitekturë e kohës është kjo
Sa shpejt harruam jetën.

Fenomeni i postmodernizmit

Letërsi e çmendur

Me këtë rast postmodernizmi edhe historikisht nisi të degëzohet në postmoderne, postmodernitet e poste të tjera (post-impresionizëm, post-industrial) të cilat u shtrinë jo vetëm në letërsi, por edhe në sociologji, industri, teknologji, etj.



Berat DAKAJ

Dje, sot, nesër!

Termi postmodernizëm lindi në vitin 1926, ndërsa paduk-shmëria e kësaj lindjeje ishte në heshtje që në vitin 1870. Atëkohë ky term qe përdorur nga artisti britanik John Watjkins Chapman. (Shih. Postmodernizmi: shkurt e shqip, Richard Appignanesi (me bashkautorë), "Rrokullia", Prishtinë 2006).

Në vitin 1970 e tutje, postmodernizmi nisi ta marrë formën e mirëfilltë si term që, së pari, nisi të shënojë një ndeshje dhe përmbysjeje të modernes, një përpjekjeje për të shënuar diçka edhe më të re, për të parë diçka më ndryshe modernes (kohës së tashme).

Postmodernia u lind dhe u rrit në shtëpinë e modernes por, duke qenë se atë e shkruante dikush tjetër, i erdhi koha ta bëjë jetën e vet; të flejë në një kohë tjetër, në retrospektivë, megjithëqë shpesh duke bërë "konak" në shtratin e modernes, e cila përpëlitet drejt të ardhmes.

Postmodernia lindi me qëllim që të shënojë diçka të re, të kohës, një ecje me kohën, njëkohësisht për ta dalluar kohën e modernes prej diçkaje që duhet të jetë më bashkëkohore, që i përshtatet të gjitha gjinive, moshave, kulturave. Shkurt e shqip, diçka që flet me akëcilin.

Me këtë rast, postmodernizmi edhe historikisht nisi të degëzohet në postmoderne, postmodernitet e poste të tjera (post-impresionizëm, post-industrial) të cilat u shtrinë jo vetëm në letërsi, por edhe në sociologji, industri, teknologji etj. Pra, gjithçka nisi të kalojë në bashkëkohore (postmodernizëm).

Me gjithë këtë fakt, këta terma, ta zëmë postmodernizëm e postmodernitet, dallojnë në princip. I pari, sipas studiuesit Ihab Hasan, "i referohet sferës kulturore, posaçërisht letërsisë, filozofisë dhe arteve, ndërsa postmodernitetin ia atribuon, siç thotë ai, skemës gjeopolitike, më shumë rregullit të gjendjes së çrregullt, që u shfaq dekadave të fundit".

Atëkohë nocioni 'modernus' nisi të shënojë atë që ishte e ditës, e sotme, aktuale, bashkëkohore. Pra, kishte kuptimin e së resë. Por nuk mbeti i tillë. Ai më pas iu kundërvu kohës: e sotshmja ndaj të djeshmes.

Duhet pasur parasysh se moderniteti gjeografik nëpër letërsitë botërore ishte shumë i lëkundshëm. Te ne, në letërsinë shqiptare përgjithësisht vjen me vonesë, ngaqë shkollat, ideologjitë, qarqet e ndryshme e hapin me vonesë kufirin e nocionit të modernes. Te ne, para së gjithash, modernizmi barazohet me tradicionalizmin, më pas, i mohohet edhe ky kontekst kohe dhe tradite, për arsye se pranohet një lloj teorie e letërsisë, e cila, sado që është e vonuar, pranohet si e patejkalueshme për atë kohë!

Por kush mund të sigurojë sot se postmoderniteti do të mund të mbetet bashkëkohor? Kush mund ta thotë datën e skadimit të tij? Çfarë pritet të vijë pas postmodernes, pas këtij rregulli të çrregullt?!

Studiuesit e postmodernes dhe modernes, mendojnë se lindja e postmodernizmit erdhi ngaqë modernizmi u hap dhe u zgjerua shumë! Prandaj lindi nevoja për një pasaportë universale. Çfarë do të thotë kjo? Që t'i lejohet atij që po lind udhëtimi në secilin vend dhe në çdo kohë!

Sipas pikëpamjeve të tyre, postmodernizmi është bashkëkohor, por i viziton të gjitha kohët; hyn në klasikë, neoklasikë, kalon në realizëm, modernizëm e në çdo periudhë tjetër qoftë të artit qoftë të shkencës. Thjesht, sipas kësaj ngjizjeje të tyre, kuptohet se postmodernizmi është shumë demokrat; një eklektizëm i hapur i llojit të vet dhe i papërsëritshëm.

Dallimi ndërmjet modernes dhe POST-it të shtuar në letërsi

POSTmodernia dallon nga modernia, pikë së pari, nga ai POST i shtuar, që shënon kohën, që i prin sidomos një letërsie të paimitueshme. Pastaj edhe nga mënyra e shkrimit/gjuha, rrjeta. Modernia e ka rrjetën më të ngushtë, të



kufizuar, nuk mund të fusësh në të gjithfarë tekstesh (intertekste postmoderne), gjithfarë figurash, gjithfarë situatash, për dallim nga postmodenia që zgjerohet e i pranon të gjitha këto që s'i pranon modernia. Kjo pranon aq sa e sheh të nevojshme, se e tëra që bart me vete ka funksion, qëllim. Prandaj, rrjeta e qepur e saj është e pakufizuar, shumë e gjerë; lidhje e fortë dhe e qëndrueshme, por edhe e çmendur!

Linda Haçion, në studimet e saj të bëra për letërsinë moderne dhe postmoderne, konstaton se ligjërimin postmodern e karakterizon paradoksi, ironia, parodia, alegoria, citati implicit/eksplicit etj.

Pra, duke pranuar këto futje figurative, këto pjesë të tekstit, e, po ashtu, edhe një ligjërim të shkujdesur, kjo letërsie e çmendur (postmoderne), nëpërmjet paradokseve të lëkundshme, e kthen njeriun e guximshëm në frikacak, intelektualin në hajdut, vrasësin në human etj. Në të, dhe me këta njerëz, (personazh/postmodernë) mund të ndodhë gjithçka, mund të lexoni se ai (personazhi), ecën në tokë, fluturon.

E befasishmja, komikja, tragjikja, e mrekullueshmja, e pabesueshmja, e frikshmja bashkohen, shkrihen, por edhe shpërbëhen në postmodernizëm; ligji i unitetit të stileve, po ashtu, është i dekompozuar (përzihen e ulëta me të madhërishmen), po ashtu edhe ana kompozicionale e thyen tabunë klasike, njëkohësisht edhe titullari (përmbajtja) i veprës (prozës) nuk i ngjan më veprave të zakonta, (që nuk jemi mësuar t'i shohim në veprat moderne), pos në libra shkencorë.

Loja me fjalë, me kode gjuhësore, citatet eksplicite dhe implicite e bëjnë të dallueshme postmodernen prej modernes.

Për Linda Haçion-in "poetika e postmodernizmit është në thelb poetikë e kundërthënies, paradoksit, sepse konteston atë objekt me anë të të cilit ndërtohet, pra ajo në të njëjtën kohë krijon dhe rrënon".

Për dallim prej Heçion-it, Habermasi thotë se modernizmi është projekt i pakryer, ndërsa postmodernen e sheh si lindje të re që i përgjigjet kërkesës së kohës.

Menjëherë pas tij, Litoari (1985) postmodernen e kalon përmes modernes, duke thënë se: "një vepër për të qenë postmoderne, së pari duhet të jetë moderne". Në këtë konstatim, Litoari e ofron postmodernen me bashkëkohoren, duke nxjerrë nga kjo eklektizmin (përzierjen).

Litoari, duke bërë përpjekje të japë më shumë për kohën postmoderne (bashkëkohore), shkruan: "njeriu i sotëm dëgjon muzikë reggi, shikon filma vesternë, në drekë ha Mc Donald, ndërsa në darkë gatuan ushqim popullor shtëpiak, vë parfum francez në Tokio etj".

Pra, teksti e ri shfrytëzon çfarëdo teksti tjetër (çdo germë, tingull, shenjë gjuhësore të shkruar-verbale, ose edhe orale) derisa të arrijë të krijojë një pëlhurë teksti të ri, të paimitueshëm; që dallon nga tekstet e tjera. Megjithëqë, ky tip shkrimi referencial nuk është i domosdoshëm të quhet postmodern! Këtë pranim të referencave, citateve të çfarëdollojshme mund ta bëjnë edhe tekstet që nuk janë postmoderne, mirëpo referimi i tekstit të ri ndaj një morie tekstesh, pastaj qasja ndaj tyre, figurat e përdorura (ironia, alegoria, sarkazma, paradoksi; citati implicit dhe eksplicit) e bëjnë tekstin postmodern të dallojë nga ai modern. Të gjitha këto urëkalime që interteksti postmodern bën mbi modernizmin, klasicizmin, realizmin, surrealizmin dhe nëpër periudha të tjera të artit dhe shkencës, i shfrytëzon për qëllimin që të arrijë nivelin e postmodernitetit.

Shkrimi postmodern është ai që, duke folur serioz, godet, ironizon, satirizon; zhvesh e vesh karaktere.

Studiuesi kroat Pavao Pavliçiç, në dallimin që i bën intertekstualitetit modern e postmodern, këtë të parin e sheh vetëm te një tekst konkret, ndërsa interteksti postmodern, sipas tij, "nuk ka relacion vetëm me një tekst, po me një shumësi tekstesh, përgjithësisht çdo tekst, çdo zhanër, çdo epokë". Po nga ky fakt, mund të pranohet se teksti postmodern është shumësi tekstesh (literaturë e zgjedhur, e qëllimshme), i cili realizimin më të mirë e arrin në prozë, si një katalog bibliografik, ose si libër enciklopedik: rrjetë e gjerë dhe e hapur.

Ndoshta, së shpejti, do të mund të pranojmë se, lindjet e rralla të romaneve postmoderne do t'i dobësojnë librat paraprakë të letërsive të periudhave të tjera.■



Struktura e skemës piramidale për arritjen e suksesit

Brenda secilit njeri, Zoti krijoi një talent të caktuar. Andaj, për këtë shkak, njeriu gjatë gjithë jetës duhet të orvatet për të perceptuar, përcaktuar dhe gjurmuar prirjet e tij.



Mirsad KUTELI

Zbulimi dhe përcaktimi i prirjeve vetjake është faza vendimtare e njohjes së fatit dhe e rrugës drejt suksesit. Tërë jeta jonë është e strukturuar në formën e skemës piramidale.

Përpjekjet e individit për të zbuluar shkathtësitë e personalitetit për një jetë të suksesshme, po ashtu edhe hierarkia shtetërore, janë të ndërtuara në formë piramidale. Edhe familja është e strukturuar në këtë formë. Në këtë aspekt, mund të thuhet se e tërë jeta ka një ndërtim dhe një orientim të tillë. Kjo për shkak se çdo krijesë kërkon një mbështetje diku, ashtu sikurse shtyllat e ndërtesës që mbajnë njëra-tjetrën. Edhe strategjitë menaxhuese moderne nëpër korporatat më të mëdha botërore funksionojnë nga një hierarki piramidale, ku çdo individ kryen aktivitetin e tij konform përgjegjësive që i janë dhënë dhe që i ka pranuar.

Është fakt se Zoti krijoi brenda secilit njeri një talent të caktuar. Andaj, për këtë shkak, njeriu gjatë gjithë jetës duhet të orvatet për të perceptuar dhe përcaktuar aftësitë e tij, apo siç thotë populli, atë për të cilën është i lindur. Pra, nga kjo kuptohet se njeriu lind me një prirje të caktuar. Shtrohet pyetja – pse ajo prirje nuk i shfaqet njeriut vetvetiu dhe në mënyrë imediate? Këtu ekziston një gamë obstruksionesh, kur kihet parasysh se njeriu është një qenie subjektive dhe objektive. Si konsekuencë e saj, ai ka meditime pasive dhe aktive. Në të dy rastet, ai shpeshherë e humbet një pjesë të kohës duke vëzhguar e analizuar të tjerët. E nëse ka predispozita për sukseset e dikujt në një fushë të caktuar, ai do të përpiqet për ta imituar atë. Pikërisht këtu do të pësojë shkarje në personalitetin e tij, ngase kjo do ta çojë atë drejt tjetërsimit. Njeriu në vend se të mundohet të kuptojë atë që ndryhet brenda vetes së tij, pra forcën e arsyes së brendshme natyrale, mëton ta arrijë atë artificialen.

Në kulmin e piramidës së personalitetit qëndron kulminacioni i talentit

Është fakt se për të arritur deri te suksesi nuk është një rrugë shumë e lehtë. Thamë se suksesi i ngjan një piramide, në të cilën është vështirë që të ngjitesh lart, ndërsa poshtë mund të biesh shumë shpejtë.

Nuk duhet harruar se jeta jonë është një ngjitje e shkallëve drejt majës piramidale. Në kulmin e piramidës së personalitetit qëndron kulminacioni i talentit tonë. Këtë kulminacion dikush e vëren dhe e arrin shumë herët apo në kohën e duhur, ndërsa dikush tepër vonë. Fatkeqësia qëndron nëse dikush nuk mund t'i zbulojë përjetë prirjet e veta. Megjithatë, zbulimi i vokacionit tuaj nuk është akti përfundimtar. Por, ju duhet të jeni këmbëngulës dhe të vendosur për realizimin e tij. Tani i keni hapur horizontet dhe rrugën drejt suksesit. Mjafton të ecni pa hezitim në këtë udhë. Mos e ndërroni këtë rrugë me ndonjë tjetër, qoftë edhe nëse tjetra ju duket më e bukur, sepse në atë rrugë duhet të shtegtojë dikush tjetër, ndërkaq ju do ta humbnit rrugën e vërtetë. Ndaj nuk duhet harruar, se Zoti ia ka caktuar secilit fatin dhe riskun e vetë. Kështu duhet të përpiqeni të ecni kësaj rruge, pra rrugës së fatit tuaj. Kjo do të jetë rruga më e lehtë për ju, pasi ta keni zbuluar, ngase Zoti ia lehtëson çdokujt rrugën në të cilën është nisur.

Mirëpo, kujdes! Rruga juaj duhet të ketë një qëllim. Pa një objektivë nuk do të kesh perspektivë. Në këtë drejtim, qëllimi yt gjithnjë duhet të jetë që të arrihet sa më parë zeniti i talentit apo vokacionit tënd. Ndërkaq, kur të arrihet kjo objektivë që është kryesorja, mund të arrihet lumturia e vërtetë.

Në këtë aspekt, në radhë të parë, duhet ta kuptojmë se cili është qëllimi ynë dhe çfarë shkathtësi kërkohen për arritjen e këtij qëllimi, pastaj duhet të mësohen ato aftësi, e më pas të gjitha ato shkathtësi që mësojmë, duhet t'i zbatojmë në praktikë. Për këtë edhe Aristoteli thoshte se: 'Filozofia nuk duhet të të mësojë të dish të flasësh, por edhe të veprosh'. Andaj, pa harmonizimin e qëllimeve dhe veprimeve tona nuk mund të arrihet suksesi.

Njeriu i suksesshëm nuk dorëzohet, por edhe pas ndonjë ngecjeje këmbëngul dhe gjen metoda të reja. Me këtë nënkuptohet se nuk është i dështuar ai që gabon, por ai që nuk e kupton gabimin dhe nuk e eviton atë duke kërkuar rrugëdalje. Në këtë kontekst një filozof do të thoshte: 'Nuk ka asgjë të zorshme sa të mos gjendet në të kërkuar'.

Një gjë duhet ta kuptoni qartë: suksesi gjendet kudo në natyrë, po fillove ta kërkosh, ai nis të të afrohet. Vetëm kështu mund të krijojmë afinitet për gjërat që na interesojnë. Përmes vullnetit tonë dhe guximit në kërkimet tona do të thellohemi në botën e brendshme të suksesit, duke shmangur një dozë emocionesh që zakonisht pengojnë shumë njerëz ambiciozë në fazën fillestare drejt suksesit. Kështu, duke u krekosur për sukseset e para dhe të pjesshme nuk arrijnë të bëjnë shqyrtime të hollësishme, gjë që i çon drejt veprimeve diletante. Këta persona mbeten gjithnjë mediokër dhe të frustruar, në përpjekje të vazhdueshme për të gjurmuar atë që ende nuk e kanë arritur. Andaj, mund të thuhet se njeriu nuk duhet të mendojë se ajo që ka arritur në një moment të caktuar është kryevepra e tij. Ai duhet të vazhdojë studimin dhe hulumtimin e mëtejmë drejt avancimeve dhe sukseseve të reja, duke menduar se vepra e tij më e mirë do të kompletohet në të ardhmen. Një gjë e tillë nuk do ta pasivizojë dhe do ta nxitë gjithnjë drejt kërkimit për më të bukurën dhe më të vlefshmen. ■

Aknet – "Puçrrat e rinisë"

Statistikat flasin se mbi 50 % e të rinjve në periudhën e adoleshencës kanë probleme me aknet dhe kërkojnë ndihmën e dermatologut për trajtimin e tyre. Mbi 70 milionë të rinj në gjithë botën kanë probleme me aknet, kurse në SHBA këtë problem e kanë mbi 17 milionë e të rinjve.

Artan BEJTA



Pa dyshim, një armik i fytyrës së shumë të rinjve janë aknet apo puçrrat e rinisë, siç njihen në popull. Ato shfaqen më së shpeshti mes moshës 14-20 vjeçare.

Jo rrallë ky problem mund të jetë edhe te më të rriturit, por me një frekuencë më të ulët. Statistikat flasin se mbi 50 % e të rinjve në periudhën e adoleshencës kanë problem me aknet dhe kërkojnë ndihmën e dermatologut për trajtimin e tyre. Mbi 70 milionë të rinj në gjithë botën kanë problem me aknet, kurse në SHBA këtë problem e kanë mbi 17 milionë e të rinjve.

Lëkura dhe roli i saj në organizmin tonë

Njeriu është në kontakt të vazhdueshëm me faktorë të ndryshëm të ambientit në të cilin jeton. Këta faktorë mund të jenë të nevojshëm apo të domosdoshëm për jetën e tij, mirëpo disa prej tyre mund të jenë të dëmshëm për të. Organi që më së shumti është në kontakt me këta faktorë është lëkura.

Lëkura është organi që mbështjell tërë sipërfaqen e jashtme të organizmit të njeriut; ajo është organi më i madh dhe është një nga më të rëndësishmit; peshon rreth 18-20 kg; ka një sipërfaqe 1.7 m2 dhe trashësi 1-2 mm, trashësi e cila ndryshon varësisht nga pjesët e organizmit.

Lëkura kryen shumë funksione të rëndësishme për organizmin. Lëkura është barrierë mbrojtëse që nga njëra anë pengon humbjen e ujit, elektroliteve e përbërësve të tjerë dhe rregullon temperaturën, e nga ana tjetër, pengon hyrjen e materieve dëmtuese. Lëkura mbron organizmin nga agjentët fizikë, mekanikë, kimikë dhe mikrobiologjikë.


Lëkura në aspektin histologjik ndërtohet nga tri shtresa: epiderma që paraqet shtresën më të hollë të lëkurës dhe që është e ndërtuar nga qelizat epidermale, gjëndrat e djersës, gjëndrat dhjamore, qimet dhe thonjtë; derma që paraqet shtresën më të trashë të lëkurës dhe hipoderma e cila është vendosur mes lëkurës dhe muskujve dhe përbëhet nga indi dhjamor, qeliza dhjamore të grumbulluara dhe indi lidhor.

Pasi lëkura paraqet organin e parë që bie në kontakt me agjentë të jashtëm, që janë shkaktarë të shumë sëmundjeve, ky organ ballafaqohet jo rrallë me patologji (sëmundje) prej më të lehtave, e deri te ato më të rënda. Në mesin e këtyre sëmundjeve hyjnë edhe aknet, të cilat ndonëse nuk paraqesin ndonjë problem shumë të madh, janë të mërzitshme dhe të padurueshme nga të rinjtë te të cilët ato paraqiten më së shpeshti.


Çka janë aknet?

Aknet apo "puçrrat e rinisë", siç njihen në popull, pa dyshim, janë një armik i fytyrës së shumë të rinjve. Aknet janë sëmundje të lëkurës që shfaqen vetvetiu. Ato shfaqen më së shpeshti mes moshës 14-20 vjeçare dhe po ashtu mund të zhduken vetvetiu.

Jo rrallë, ky problem mund të jetë edhe te të rriturit, por me një frekuencë



Fazat në të cilat këto puçrra zhvillohen brenda lëkurës së adoleshentëve, të cilat vijnë si pasoj e shumë faktorëve



më të ulët. Statistikat flasin se një përqindje e madhe e të rinjve në periudhën e adoleshencës kanë probleme me aknet dhe kërkojnë ndihmën e dermatologut për trajtimin e tyre.

Lokalizimi i akneve është i shprehur më shumë në lëkurën e regjionit të fytyrës dhe shumë rrallë edhe në regjionet e tjera të lëkurës dhe kjo është edhe arsyeja kryesore që të rinjtë ndërhyjnë në to, ose duke i ndrydhur, ose duke i trajtuar me kremra dhe preparate të ndryshme kimike, pa u konsultuar me dermatologun dhe duke shkaktuar kështu vetëm përhapjen e inflamacionit dhe probleme akoma më të mëdha.



Shkaktarët e paraqitjes së akneve

Ndër shkaktarët e kësaj sëmundje përmendet faktori trashëgues, pastaj faktorët psikologjikë, fluksi hormonal (rritja e disa hormoneve), përdorimi i kremrave të ndryshme kozmetike, si dhe ushqyerja jo e mirë, sidomos ajo e pasur me yndyra dhe e varfër me vitamina.

Shkaktarë të paraqitjes së akneve, sidomos jashtë moshës, konsiderohen më së shumti gjendjet e ndryshme dhe të vazhdueshme të stresit. Sipas specialistëve të kësaj lëmie (dermatologëve), gjatë këtyre situatave, organizmi prodhon një numër të madh hormonesh (sidomos hormonet androgjene) që janë përgjegjëse për paraqitjen e akneve. Jo rrallë në paraqitjen e akneve ndikojnë edhe shkaktarët ekzogjenë apo të jashtëm.

Paraqitja e akneve më e shpeshtë është tek të rinjtë që kanë një lëkurë të yndyrshme. Në folikulin e qimes grumbullohet yndyrë e cila në lëkurë e krijon një substancë që quhet "sebo" e cila prej andej del jashtë folikulit duke shkaktuar pamjen e një fytyre të lëngshme.

Si paraqiten aknet?

Mekanizmi i paraqitjes së akneve gjatë adoleshencës sqarohet me rritjen e numrit të madh të hormoneve, gjë që shkakton prishjen e balancimit (ekuilibrit) të këtyre hormoneve në organizëm. Mekanizmi i paraqitjes së akneve kalon nëpër katër faza.

Fillimi i paraqitjes së akneve karakterizohet paraqitja e pikave të zeza, të cilat shërbejnë si tapëza që pengojnë daljen jashtë të sekrecioneve që normalisht eliminohen nga lëkura. Si rezultat i kësaj kemi grumbullimin e këtyre sekrecioneve dhe paraqitjen e akneve. Pasi të jetë grumbulluar sekrecioni, fillon paraqitja e një inflamacioni lokal dhe paraqitja e qelbit me praninë e baktereve. Vazhdim i këtij procesi është formimi i noduleve (nyejve) të cilat shpesh lënë shenja të paevitueshme në lëkurë dhe paraqesin problem estetik për të rinjtë, duke prishur integritetin e lëkurës. ■

Këshilla për aknet

1. Mos ndërhyni në pikat e zeza apo në akne, qoftë me duar duke i ndrydhur ato, qoftë edhe me trajtimin e tyre me preparate të ndryshme kimiko-kozmetike, pa u konsultuar paraprakisht me dermatologun.
2. Eliminoni ushqimet e skuqura dhe të yndyrshme, pasi ato janë armiku i lëkurës suaj.
3. Mundohuni që ushqimi që konsumoni të jetë i pasur me shumë vitamina, sidomos me vitaminat A, C, E. Pini shumë ujë, por jo të gazuar, sepse përdorimi i tij shkakton hidratimin e lëkurës.
4. Konsultohuni gjithmonë me specialistë të kësaj lëmie (dermatolog).

Pranimi i Kosovës në organizatën e futbollit botëror – mision “gati i pamundur”

Futbolli duhet të presë politikën

Anëtarësimi në UEFA e FIFA është kushtëzuar me pranimin e shtetit të Kosovës në OKB. Fakti që Kosova nuk është një shtet anëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara pritet të jetë pengesa e madhe për Federatën e Futbollit të Kosovës, për t’u bërë anëtare e FIFA-s.

Liridon IBERDEMAJ

Federata e Futbollit të Kosovës ka bërë aplikimin për anëtarësim në FIFA, që ka qenë një ëndërr e futbollistëve të Kosovës për dekada me radhë. Kryetari i FFK-së, Fadil Vokrri ka dorëzuar më 6 maj, në selinë e shtëpisë së parë të futbollit botëror, në Cyrih të Zvicrës, një dokumentacion voluminoz dhe kjo është e tëra që ka mundur të bëjë FFK-ja, pasi, prej tani, topi është në anën e institucionit botëror të futbollit.

Mbi 300 faqe me dokumentacion të plotë, i paraparë me rregulloren e FIFA-s për aplikim, presin tashmë të shqyrtohen nga Kongresi i kësaj organizate, që do të mbahet në Sidnej të Australisë më datat 29 dhe 30 maj. Zyrtarët e futbollit të Kosovës kanë deklaruar se kanë marrë premtimin se kërkesa e tyre do të shqyrtohet në këtë Kongres.

Anëtarësimi në UEFA e FIFA është kushtëzuar me anëtarësimin në OKB

Gjithsesi aplikimi nuk nënkupton pranimin e domosdoshëm në një të ardhme të afërt. Madje në rastin e Kosovës gjërat duken akoma të komplikuara, thuajse njëlloj si para shpalljes së pavarësisë së shtetit të Kosovës.

Fakti që Kosova nuk është një shtet anëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara pritet të jetë pengesa më e madhe për Federatën e Futbollit të Kosovës për t’u bërë anëtare e FIFA-s. E vërteta është se futbolli i Kosovës për t’u bërë pjesë e familjes evropiane, e me këtë edhe asaj botërore, i duhet medoemos që të presë anëtarësimin e shtetit të pavarur të Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Në statusin e FIFA-s, në nenin 10 të tij, në paragrafin e parë thuhet se “çdo federatë që është përgjegjëse për organizimin dhe mbikëqyrjen e futbollit në vendin e saj mund të bëhet anëtare e FIFA-s. Në këtë kontekst shprehja “vend” i referohet një shteti të pavarur të njohur nga komuniteti ndërkombëtar. Ky paragraf mund të komentohet në mënyra të ndryshme pasi askund nuk përmendet termi: “Kombet e Bashkuara” por “komuniteti ndërkombëtar”. Gjithsesi, në paragrafin vijues (paragrafi 2 i nenit 10) të statutit të FIFA-s thuhet se “anëtarësimi u lejohet vetëm federatave që kanë qenë anëtare të përkohshme të një Konfederate për të paktën dy vjet”. Kjo bën që adresa e FFK-s për pranim ndërkombëtar të jetë organizata e parë e futbollit evropian, UEFA.



Është dëshmuar më shumë se njëherë se pranimi në UEFA nuk është një gjë e lehtë, pasi më shumë vendos politika se interesat e futbollit. Vetëm nëse federata jonë do të arrinte të bënte një lobim aq të fuqishëm sa ta bënte UEFA-n që ta ndryshonte statutin e saj, apo të bënte një përjashtim për rastin e Kosovës, atëherë do të mund të realizohej pranimi i futbollit të Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Në paragrafin e parë, të nenit të pestë, të statutit të organizatës që qeveris futbollin evropian thuhet: “Anëtarësimi në UEFA është i mundur për federatat e futbollit që gjenden në kontinentin e Evropës, me qendër në një vend që njihet nga Kombet e Bashkuara si shtet i pavarur, dhe që është përgjegjëse për organizimin dhe implementimin e



çështjeve që kanë të bëjnë me futbollin në territorin e vendit". Kjo fjali vazhdon të jetë akoma barriera që ndan futbollin e Kosovës nga të qenit pjesë e UEFA-s dhe FIFA-s.

Megjithëse FIFA ka më shumë vende anëtare sesa që ka Organizata e Kombeve të Bashkuara, është pikërisht paragrafi i mësipërm ai që pamundëson anëtarësimin e Kosovës në UEFA, e rrjedhimisht edhe në FIFA, pa qenë më parë anëtare e OKB-së. Në statusin e FIFA-s (neni 10, paragrafi 6) thuhet se "Një federatë futbolli që përfaqëson një territor që akoma nuk ka fituar pavarësinë mund të aplikojë për anëtarësim në FIFA, nëse ka autorizimin e federatës së vendit të cilit ky territor i takon".

Fakti që Kosova nuk është më një territor i një shteti tjetër e bën të pavlefshëm paragrafin e mësipërm.

Në rrethana të tilla aplikimi për pranim në UEFA dhe FIFA mund të ketë shërbyer vetëm sa "për të hequr merakun", si ndodhi me rastin e federatave të basketbollit apo hendbollit, që u refuzuan nga ana e institucioneve botërore për t'u bërë anëtare me të drejta të plota.

Mundësia për një lobim të fuqishëm në konfederatën evropiane të futbollit, që ka 53 anëtarë dhe ku për fat të keq politika luan një rol shumë të rëndësishëm, duket mjaft e paktë dhe kërkesa për t'u pranuar me një procedurë të veçantë duket tejet e vështirë për t'u realizuar, për të mos thënë e pamundur.

Kjo e detyron komunitetin e futbollit në Kosovë që të vazhdojë të presë në mënyrë paradoksale politikën që të bëjë hapin e parë. Se kur do të arrijë politika që ta kryejë me sukses misionin e sigurimit të një ulëseje në Organizatën e Kombeve të Bashkuara është një çështje që nuk varet aspak nga futbollistët, apo Federata e Futbollit të Kosovës.

Tifozët e Kosovës që kanë kohë që ëndërrojnë t'i shohin skuadrat e tyre të zemrës në garat kualifikuese të Ligës së Kampionëve, Kupës UEFA apo Kupës Intertoto, apo edhe Përfaqësuesen e Kosovës në kualifikimet për Kampionatet botërore e evropiane, do të duhet të vazhdojnë të përkrahin skuadrat e tyre të zemrës vetëm në ndeshjet brenda vendit dhe të vazhdojnë të presin.

Edhe sa?... E vështirë të thuhet!



Kryetari i FFK-së, Fadil Vokrri dhe Presidenti i FIFA-s, Sepp Blatter

OKB 192 anëtarë, FIFA 208 anëtarë

Aktualisht në botë janë 11 federata që janë të anëtarësuara në FIFA, por që nuk kanë statusin e vendit anëtar të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Ishujt Faroe, Anguilla, Makau (Kinë), Montserrat, Kaledonia e re, Tahiti e Ishujt Turks dhe Caicos janë kryesisht territore pa sovranitet të plotë shtetëror dhe vende me popullsi e territor më të paktë se Kosova, por që kanë fituar të drejtën për të qenë anëtarë të konfederatave kontinentale të Amerikës së Mesme dhe të Veriut apo Oqeanisë, e me këtë edhe të FIFA-s. Logjikisht Kosova ka më shumë të drejtë për të qenë anëtare e FIFA-s, se të gjitha këto vende. Por problemi është se çdo federatë duhet të anëtarësohet fillimisht në UEFA dhe kjo sjell edhe anëtarësimin automatik në FIFA.

UEFA si institucioni qeverisës i futbollit evropian ka statutin dhe kushtet për anëtarësim të ndryshëm nga pesë konfederatat e tjera kontinentale të FIFA-s.

Në Evropë i vetmi vend që është anëtar i UEFA-s dhe FIFA-s dhe që nuk është anëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, janë Ishujt Faroe. Ky rajon autonom i Mbretërisë së Danimarkës është anëtarësuar në FIFA në vitin 1988, ndërsa më 1990 është bërë edhe anëtar i UEFA-s, por për këtë gjë federata e këtij vendi ka pasur lejen dhe përkrahjen e Federatës Daneze të Futbollit.

Rasti i Anglisë, Skocisë, Uellsit dhe Irlandës së Veriut që nuk janë anëtare të OKB-së (pasi janë pjesë e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe) është krejt i veçantë, pasi federatat e këtyre vendeve janë ndër themelueset e FIFA-s dhe për këtë gëzojnë privilegje të trashëguara në shtëpinë qeverisëse të futbollit botëror.

Ndërkohë, sot, në botë ka edhe vende që janë anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, federatat e të cilave nuk janë anëtarësuar në FIFA. Në Evropë, Principata e Monakos, që është anëtare e OKB-së prej vitit 2003, vazhdon të mbetet jashtë UEFA-s dhe FIFA-s. Ndërsa në gjithë botën janë edhe Kiribati, Ishujt Marshall, Mikronezia, Nauru, Palau e Tuvalu që gjithashtu nuk janë pjesë e FIFA-s. ■

Fjalëkryqi

Autor: ENDRITI	FUTBOLLISTI LEGJENDAR ARGJENTINAS	SHKENCA QË STUDION NDËRTIMIN E ORGANIZ-MAVE TË GJALLA (pashq.)	ILUZIONISTI SHQIPTAR MURA	KËNGËTARJA PERUANE SUMAK	TË HOLLA	UTAH, LUISANA	LLOJ PIJE ALKOOLIKE (shq.)	ISTRES	SHTAGAT		GRUP KËNGËTARËSH (sh.shq.)	FUTBOLLISTI FETAHU	LLOJ BIME NARKOTIKE (shq.)	URANIUM, LITËR, AMPER
MASHTRIM NË MËNYRË TË STËRHOLLU-AR										KLUB I YNI FUTBOLLI / TONI ANDERSON				
SHKENCËTARI YNË SKËNDER								QË ËSHTË ME TINGUJ TË ÇRREGULLUAR / AKTORI I FAMSHËM NW FOTO DELON						
RADIOLOKAT-OR						AKTORJA SHQIPTARE JOSIPI / QYTET I MADH BREGDETAR NË ITALI								
BABAI				EMËR MASH. TË KRISHTERË (shq.) / FEMËR LUFTËTARE QË NUK MARTOHEJ (mit. gr.)						ESANDA (shq.) / JO I VËRTETË				KËNGËTARJA BRITANIKE UAJNHAUS
GJYMTYRË E TRUPIT					VEND LUFTIMI I GLADIATORËVE (sh.shq.) / KËNGËTARJA AMERIKANE BAKER							DETIM / SHUMË I MADH		
NJËSI E REZISTENCËS ELEKTRIKE			DETAR / LLOJ HELMI LUFTE (shq.)								ATLETI AMERIKAN MONTGOMERI / FEMËR E POSAMARTU-AR (sh.shq.)			
LLOJ VETURE (shq.)							TINKA KURTI	SPORTI I BARDH / JO ÇIFT						
ZANORE		NJË KONTINENT / E TRISHTUAR				SHKRONJA TË NJËJTA / SHKENCËTARI NJUTON (shq.)			TOPI JASHTË LOJE					KËNDOJ PSALME
	DASHURORE / VEGËL MUZIKORE								LËVIZJA SOCIALE AUSTRIAKE / JANË (ang.)				BASHKËT-INGËLLORE / INDUSTRIA E NAFTËS ZAGREB	
BANOR I NJË QYTETI TONË							DEM, BIK / AKTORJA HOLLIVUDIANE BRUK			KOMPOZITORI PRESHEVA / ELIZABETH TAYLOR				
KËNGËTARE E JONA E RE					ANNA KONTE / NDJENJË E LAKMISË QË NA NGJALLET KUR SHOHIM DIKË MË MIRË SE VETEN (sh.shq.)			PJESË E SYRIT / EMËR YNI MASHKULLI						
LLOJ VETURE FRANCEZE				TËRËSI E ESHTRAVE TË NJERIUT / HIT NGA ARDIT GJEBREA							KAFSHË SHTËPIAKE			
NOTË MUZIKO-RE			MUNGESË GJALLËRIE, ZHVILLIMI E PËRPARIMI / ANCONA						GJENDJE PLOGËSHTIE SHPIRTËRORE, LIMONTI					
PASURI E PATUNDSHME QË SILLTE TË ARDHURA (tur.)						ARMATA REPUBLIKANE IRLANDEZE / EAST								
NORA ISTREFI			IRNOSE / KËNGËTARJA FARA				ISMET PEJA / SAHATI							
PARA TË NËNTËS						TEATËR NË PRISHTINË / AZEM MAKSUTAJ								
MISH				LLOJ LETRASH FATI / ZANORE										
BISHË MALI (shq.)					PASION I TEPRUAR PËR DIÇKA									